

Prof. Mehmet Vokshi
SHQIPNIJA E SHQIPTARVET
Afër njizet shekuj luftnash e lëvizjesh komtare

Moto: *Nji gjuhë e një Atdhe*

Botimi i parë
Shtyp. “**Mbrothësia**” Kristo P. Luarasi
Tiranë, Janarë, 1930

Redaktor i botimit të dytë
Dr. Hakif Bajrami

Shtëpia botuese **Era**
Prishtinë, 2001

Editor
Begzad Baliu
bbali@yahoo.com

RËFYJSJA

Kufitë etnografik të Shqipnisë

Afër njizet shekuj të luftës

Prej traktatit të Berlinit në luftën Evropjane

Cungullimi i fundit

Shtypjet ose perdhunitë serbe

Pushtimi grek

Njisiimi ekonomik

E drejta komtare

Me rastin e botimit

MEHMET VOKSHI DHE DIPLOMACIA KOSOVARE

Duke hulumtuar në Arkivin e Beogradit, më 1976, rastësisht, siç ngjet gjatë asaj pune të mundimshme, hasa në një dosje jo të zakonshme. Në fillim ishin plasuar biografite e tridhjetë e tetë personaliteteve kryesore shqiptare. Në fund ishte veçuar një nëndosje e vaçantë ku prezentoheshin emrat e dyqind e katërbëdhjetë intelektualëve (ylemave) shqiptarë të Kosovës, që nga Jeni Pazari e deri te Dibra. Të gjithë këta intelektualë ishin të vlerësuar të likuidohen.

Në ato momente të zbulimit të ndonjë dokumenti të tillë, hulumtuesi i pasionuar zakonisht ndalet dhe pushon. Edhe unë veprova ashtu si me instikt. Dola jashtë ndërtesës për të marrë ajër të pastër. Provova që të mos mendoj fare për dosjen, dhe të paktën të pushoj për një orë. Përkundrazi, mezi durova disa minuta dhe u ktheva e fillova të lexoj dosjen nga fundi. Pse? Ndër emrat që figuronin aty hasa edhe në një emër që për mua ishte i panjohur, por që ishte i nënvizuar. Ishte fjala për profesor Mehmet Vokshin dhe studimin e tij: *Tuta l'Albania di tuti Albanezi*, Romë. Fillova ta shfletoj me kujdes këtë studim, për të parë se për cilat probleme flet autori. Në të vërtetë, edhe pse nuk e njihja gjuhën italiane, aq sa ta kuptoj me korrektësi, deri kah mes i studimit mësova se kah duhet të zgjerohem për t'a studiuar më tej çështjen e Kosovës 1912-1941, pas më shumë se një vit hulumtimesh që kasha bërë. Ishte prof. Mehmet Vokshi ai i cili do të më drejtoj përms studimit të tij ta hulumtoj edhe studimin të cilin ai e citonte: *Freundlich Leo, Albaniens Golgotha*, Wien 1913. Këtë studim të nesërmen e sigurova në gjermanishtë dhe të përkthyer në serbishte në Arkivin Diplomatik të ish-Jugosllavisë. Gjithashtu në dosjen e Mehmet Vokshit e gjeta edhe studimin e Gjergj Bisakut, *Lotët e Dukagjinit*, 1931. Në atë dosje ishte paluar me kujdes edhe një nëndosje e letrave të Hasan Prishtinës, dërguar institucioneve ndërkombëtare në Gjenevë gjatë viteve 1921-1931. Në dosjen e Mehmet Vokshit, ishte edhe kjo informatë: *Les Droites de l'Albanie et ses frontiers naturille*, Vlorë, 1921.

Në fund të dosjes ishte plasuar studimi i Mehmet Vokshit në përkthim, i shkruar me makinë në gjuhën shqipe, serbishte dhe italishte. Po në fund të dosjes, ishte plasuar

një urdhëresë në katër pika e firmosur dhe e vulosur nga Gjeneralshtabi i Ushtrisë së Mbretërisë Jugosllave.

Në pikën e parë shkruante se Mehmet Vokshi duhet të likuidohet me atentat. Për atentatorin ishin caktuar 100.000 dinarë sikurse edhe për Bajram Currin. Vetëm për Hasan Prishtinën dhe Mithat Frashërin ishin paraparë shuma të dyfishta për likuidim, nga 200.000 din. Sa u gëzova që i zbulova gjithë ato dokumente, po aq u hidhërova kur i hasa në emrat e shqiptarëve që ishin caktuar për likuidimin e liderëve më të njohur shqiptarë.

Prof. Mehmet Vokshin fillova ta admiroj. Kush ishte ai? Kishte kë të gjallë? A mund ta shihja nëse do të shkoja në Shqipëri, apo mos ishte diku në Kosovë? Një vit jam ndrydhë e shtrydhë nga t'ia fillojë për t'a zbuluar atë njeri, i cili në studimin e tij të shkurtër, me modesti të rrallë i kishte vënë pothujase të gjitha informatat dhe të gjitha argumentet opinjonit evropërimor, duke i prezantuar të gjitha padrejtësitë që u ishin bërë shqiptarëve nga Kongresi i Berlinit e këndej.

Në këtë paraqitje të parë, po e theksojmë edhe këtë të dhënë. Në një dokument të përpiluar më 1938 thuhej edhe kjo: *“Nëse nuk mund të likuidohet Mehmet Vokshi, atëherë duhet të fillohet me likuidimin e të gjithë shqiptarëve. Shqiptarët nuk duhet lejuar të shkollohen. Nuk duhet lejuar të bëhen as korrier në ndonjë zyre të rrethit këtë racë antiserbe. Nuk duhet lënë të merren as me fiskulturë, sepse forca e kësaj race paraqet rrezik për synimet tona për të dale Serbia në det të hapur.* Edhe në bazë të konventës Jugosllavo-Turke për shpërnguljen e shqiptarëve në Anadoll (1938) e kasha plotësuar mozikun e diturisë për objektivin me të cilin merrej prof. Mehmet Vokshi me shokë, për të mbetur Kosova në plisa.

Prof. Mehmet Vokshi me studimin e tij i la popullit shqiptarë dhe inteligjencisë shqiptare një porosi të nivelit promotor: *“Të ndërtohet Shqipëria e të gjithë shqiptarëve”*, porosi kjo që, nuk besoj se shqiptarët nuk do ta plotësojnë.

Dr. Hakif Bajrami

KUFITË ETNOGRAFIK TË SHQIPNISË të caktuem po prej nji sllavi

Nuk asht e mundun me bisedue mbi problemën kombëtare të Shqipnisë, per pa e marrë parasysh e m'e pershkue ngutsisht zhvillimin historik të gjatë dhe të shtjellueshëm, per me i caktue disa pika e shenja të domosdoshme e me randësi qi vyejnë per me i'a spjegue karakteristikat e sajë.

Por se, para çdo gjaje, asht nevoja me i caktue aproksimativisht kufitë e Shqipnisë, ose ma mirë me thanë të kombit Shqiptarë. Ky nuk asht qenë i përfshimun krejtësisht mrenda kufive të tashëm politik të Mretnisë së vet të re, dhe dobare n'ata ma të gjanët kufijë t'etniçitetit ose të njisimit etnografik të vet sod të njoftun. Por, per qellimet praktike të studimit, t'onë, e caktojmë mvehtësimin e Shqipnisë, per m'e vijue historinë e ashpërt dhe të shtjellueshme ndër kufitë etnografik të cilt, me nji mendim të përbashkët janë vërtetuem prej studjozëve të pa anshëm, mrenda të cilvët banon e gjendet në nji shumicë të madhe qi flet gjuhen shqiptare.

Kta kufi nisen prej buzëve t'Adriatikut, nga gryka e Shpuzës (spitza), pak ma në veri të Tivarit, dhe kështu përmyllin –tuej e ndjekë nji drejtim të verilindjes – liqenin e Shkodrës, malet e Tergovishtës, të Shkodrës, Hotit, të Grudës, Gusionës, Plavës, të Pejës, krejt rrafshinën veriore të Mitrovicës, deri në katundet e Kushumliës, dhe të Prokupës: prej këtu zbresin kah juga deri në Kumanovë tuj e ndjekun vijën e caktueme prej qytetit të Shkupit, të Manastirit, Kosturrit, Artës, Prevezës, dhe prap n'Adriatik. Në kët qark ose në kto vende qi janë masë e njinjishme shqiptarësh, janë dy zona të përzimuna: njena e caktueshme ndermjet Gjakovës, Mitrovicës, Novibrodit, Prizrenit prej Shqiptaro-Serbësh, por me nji shumicë të bisedueshme Shqiptare: dhe tjetra e perfshimne ndërmjet qytetit të Dibrës, Shkupit e Kosturrit prej Shqiptaro-Bullgarsh, por gjithnji me nji shumicë të dukëshme shqiptarësh.

Kta kufijë të përgjithshëm etnografik te Shqipnisë nuk janë trejtuar prej ndo'i shqiptari, por prej nji sllavi P. F. Bradaska, i cili i ka botue në "Patermann's Mitteilungen" të vjetit 1869 (XII) në nji studim kushtuemun sllavëvet në Turki ("Die sllaven in der Turkei").

E konsiderojmë prandaj në historië dhe në realitetin komtarë të caktuemit të tashëm, prej ktyne kufive, Shqipninë e vërtetë, e njoftune në nji kohë kur nuk ishin lëmun akoma dëshirat e untshme politike, luftnat komtare dhe propagandat pergenjeshtruese të çdo realitetit ma filluer të kombeve të ndryshme të Ballkanit.

AFËR NJIZET SHEKUJ TË LUFTËS

Tash ma asht i njinjishëm opinjoni i historianvet, i gjeografistvet dhe i etnografistvet se Ilirjant dhe Thrakasit do të kenë zanun –në të parat kohna qi paten mundun me u njoftë –gati krej Gadishullen Ballkanike në jugë të Danubit, dhe qi shqiptarët do të jenë ma të drejtëperdrejtmnit dhe autentikt (të përgjashmit) zbritës ose trashgimtarët e Ilirjanvet. Në ket mëndyrë, në historinë e Ballkanit dhe ma tepër n'atë të zones prendimore, shqiptarët perfytirohen komb i vërtetë auktokton.

Roma, mbasi kapercej Adriatikon, themeloj nder provinçet e veta Iliriën-Ilirium. E mbas prishjes së Perandorisë romake toka Shqiptare kaloj nder sundimin Bizantin,

por e kërcnueme dhe e zaptueme prej kryetarevet e zotnivet të vendit dhe prej republikave detare qi ishin gjithmonë në luftim në mes të tyne. Në shekullin V, mbasi i'u shtrure zaptimit të Gotvet, asht e kërcnueme dhe mësyhet prej ungarezvet dhe prej avarvet.

Mbasi u kthye prap nder sundimin e Perantorisë s'Orientit më 535, përsëri zaptohet prej tallazëve të të huajvet, të cilt shtyhen prej së mbrendshimt drejt kah deti: bullgart t'ardhun nga Asia i futen kah juga, në vendin qi quhet Epiri i ri dhe i vjetër; serbt t'ardhun nga ana e pertejme e karpateve, i futen nga veriu, në mes të grykave të Kotorrit dhe të Shkumbinit. Ktu vjen ndeshja e luftnavet të para të cilat nuk u prenë më deri më sod, ndërmjet sllavëve e shqiptarëve.

Jemi në shekullin VII. Atëherë shqiptarët njësoheshin në 15 deri 20 miljun frymësh.

Sundimi i zaptuesvet serb asht i ashpert dhe shkatrues. Por, megjithse të masakruem e të paksuem, shqiptarët qindrojnë dhe ruhen ndëper malet e tyne, kështu qi atëherë kur sundimet e sllavëve zhduken, prej tallazeve të mdhaja të sundimit Turk, populli shqiptarë –megjithëse i paksuem per kah numri –prap asht i gjellë e present.

Nder kohë, atëherë kur janë duke u shkëmbye ngjarjet në mes të Bizantinvet, të Serbvet dhe të Bullgarvet, Shqipnija zhvillonte tregtien e vet, sidomos kah Italiya, me republikat detare të Venedikut e të Amalfesë, tuj endun nji system marredhanjesh, herë vetëm ekonomik, edhe herë endë politik, me tjetren anë të detit Adriatik, e ky system maredhanjesh qysh prej asajë kohe e kendej vazhdon per pa u premë kurr.

E lakmueme dhe e kërcnueme në mes t'Ungarezve (Magjarrve) dhe të Normanëve në shekullin XI, edhe e zaptueme prej venedikasvet kah brigjet e detit në kohën e të katërtës Kryqzatë, aty kah i XIII e i XIV shekull, Shqipnija kalon ma parë ndër sundimin e Carëve të Ruisë dhe masandej nder ate të mbretënve të Serbisë Rashaj, të cilët prej viseve veriore të Shqipnisë përhapen ndëper tokët shqiptare deri në kohën e Stefan Dushanit (1331-1355) i cilli u quejt Car i Rumenisë, i Sllovenisë dhe i Shqipnisë. Por edhe atëherë shumë prej tokëve shqiptare –tuej luftue kundër sllavëve –u ikin sundimit të tyne.

Shqipnija e mesme dhe ajo e jugut, kalojnë ndër sundimin e mretënve të Svevëve dhe të dy Siçiljeve, deri sa në përparimin e parë të mësyemjes së turqvet, mbas shemjes së Perandorisë së madhe të Balshajve, zaptimi serb zvoglohet vetëm në Tivarë dhe n'Yllqin; edhe n'tjetren anë viset e Drinit dhe të Shkodrës zaptohen prej venedikasve të cilët aty kah shekujt 14 e 15, e përhapin sundimin sidomos ndeper brigjet e detit e shpesh herë me zhdukjen e kryetarve të vendit qi kishin zaptue vise të ndryshme, tuj u shtye kshtu progresivisht në Durës, Lesh, Kruej, Pulaj, Vlonë, Butrint, Pargë, Yllqin dhe në të gjithë bregdetin e detit të Tivarit deri në grykat e Kotorrit.

Në ket periudhë t'influences së madhe të venedikasve asht qi u duk Gjergj Kastrioti, ma e madhja fytyrë heroike e vendit në historinë Shqiptare dhe aq sa m'e trajtue nji pamje komtare të vetën të posaçme.

Gergj Kastrioti, i biri i Gjon Kastriotit, zotnië shqiptarë ndër viset e Malsisë, e i mbikqyrun prej venedikasve e i thyem prej turqvet në vjetin 1410, u muerr peng prej turqvet në Stamboll sbashku me të tre vllaznit e vet. I përkraun prej Sulltanit per mendjen dhe trimnien ushtarake të tij, në moshën fort të re, u duk n'Anadoll si komandant i trupave të turqve qi e quejnë Skander Bej (Zotni Aleksandër) prej kah i mbetet emni Skanderbeg, me të cilin masandej kalon në historinë shqiptare. Mbasi duel n'Evropë, tuj luftue kundër grekvet, serbvet dhe ungarezvet, u emnue

sundimtarë i Krues, dhe ktu befaz organizon, n'emen të njej bashkimit të shqiptarvet, kryengritjen kundër Sulltanit të Turkisë. Shum Kryetarë të viseve të Shqipnisë bashkohen me të. Me fuqitë e para të përmbledhuna, Skenderbegu, zapton vendet ma te randsishmet dhe ma të fortat qi sundojnë rrugat e pakta të maleve të cillat lejojnë hymjen në Shqipni; dhe menjherë e përhapë auktoritetin e vet në Tiranë, Durës, Petrelë e deri në Dibër.

Mbas themelimit në Lesh të Bes-lidhjes së Popullit Shqiptarë, të ciles i'u bashkuen edhe shumë nga ma të fortit pari të shqiptarvet, u ban ballë trimnisht – me pak fuqi shqiptarësh t'armatosun befaz –aty në vjetët 1444 dhe 1467, mësymjeve të shpeshta dhe shum t'ashperta të turqvet, tuej formue kshtu një sundim e një zotnim vertetë kombtarë, i cili përhapet në një qark të gjanë të Shqipnisë së Mesme ndërmjet Krues, Matit dhe Dibres, i shtron ndër vedi parinë e viseve dhe pohohet me një individualitet të vetin ende me raportet nderkombtare, jo vetëm në luftimet kundër Turkisë, por edhe në ngacmimet me vendikasin, për çeshtjen e sundimit t'Ylqinit, ashtu dhe kundrejt shpisë aragoneze të Napolit. Mbas deks të Skenderbegut, në vjetin 1467, Mbretinija e parë e tij shpejt zhduket. Dhe Shqipnija pothuese gadi krejt mbetet ndër thundrën e Turkisë, ndonse në Shkodër dhe ndëpër të tjera qytete të buzëve të detit, sikur Tivari, Ylqini, Durësi e Vlona, mbeten nder sundim të venedikasvet; por se edhe kta të shtymun prej turqvet fillojnë të tërhiqen kadalisht tuej i humbun –aty ka vjeti 1690 –ma të mramet pozita.

Por se edhe në ket kohë turqit nuk janë krejt zotnuesat të Shqipnisë. Në veri dhe në jugë, fiset malsore të Mirditës dhe të Çamrisë, ndëpër malet e bjeshkët e tyne, e, edhe kur shtërngohen me t'u shtrure turqvet, munden m'e fitue prej tyne njoftjen e njej autonomije të vendit.

Ma vonë, ndër shumë pari të vendit të cilt i qindrojshin influences turke, per sa u ishte e mundun, duel edhe një here në 1572 fytyra e Ibrahim Begollit, të Pejës, i pari pashë i vendit, i cili mundet m'e themelue një qeverim të vetin në njenën pjesë të Shqipnisë veriore, i cili u rruajt prej trashgimtarve të vet deri në vjetin 1830. Krejt historia shqiptare e shekujvet XVI dhe XVII, ushqehet pa premun me të tilla, ngjarje e kryengritje kundër zaptimit të turkut, dhe kshtu bahen përprjekje të mdhaja per me themelue qeverina shqiptare vendore.

N'arkivet e Venedikut gjinden të pa sosuna kerkesat e shqiptarve qi lypin ndihmen per me u lirue, dhe kjo ngjanë në vjetët 1570-1571-1580 –1596-1603 dhe në 1616. Në ket perprjekje të pa sosune kunder turqvet, shqiptarët t'ia dhurojnë qeverimin e tokave të veta –Princave të huej: në vjetin 1592 Karl Emanuelit të Savojës, dhe në vjetin 1606 Dukut të Parmes, i qujtun Renuccio I Farnez. Por se luftimi nuk i'u del dhe humbin. Mungon auktoriteti dhe zotsija e njej Kryetari të njëshëm, sikurse ishte Skenderbegu, i cili t'i zhduki pjesët apo partitë e vendit dhe t'i bashkojë qytetet e fisit e malsorvet nder një flamur të njëshëm. Por edhe në ket kohë –ma shum se në të tjerat –shofim se dalin disa prisa të cilët perpiqen per idena ma të gjana: në Shqipnin veriore Mehmet Bushati, i cili në gjysmen e shkullit XVIII e përhapsë sundimin e vet prej fiseve të ndryshme të Malsisë deri n'Yllqin dhe prej Adriatikut në Lesh, n'Elabasan, Tiranë e Dibër, tue i'a lënë në trashgim djalit të vet, i cili vdes i mbytun sikurse i ati i tij prej denimit të turqvet: edhe në Shqipninë e jugës del Ali Pash Tepelena i Janinës, i cili tuej u kundërshtue turqve, i fut dhe i shtjen ndër qeverimin e

vet Kryetarët e Elbasanit, të Beratit të Krues, dhe të tjera qendrave të Shqipnisë Veriore.

Mbas ktyne përpjekjeve, të Shqiptarëvet, Tyrkija e pohon ma serjozisht sundimin e vet mbi Shqipninë; dhe i zhdukë fare ende ato pak autonominat locale që deri atëherë ekzistonin. Ktu jemi në pragun e shekullit XIX, në premdverën e shumë komsinave që rilinden. Shkëndija dhe ndjenja komtare e Shqipnisë nuk është shue.

Në mes të vjetit 1821 dhe 1827, ndizet kryengritja Greke. Ktu, në krye të kryengritësve grek, janë dy shqiptarë, Mark Bokarisi dhe Odhisej, të cilët në këtë kryengritje e shofin lëvizjen e lirimit kundër turqvet që do të shtërngohen me u zmbrazhë larg nga Adriatiku. Kryengritjes Greke i vazhdon ajo e Shqipnisë së jugut dhe e të mesmes, me gjithë se kjo është ma e pa rregullt, e masandej kjo kryengritje përhapet në Shqipninë veriore, edhe vijon gadi gjithnjë prej vjetit 1830 deri në vjetin 1847. Kto kryengritje mujten me u shue vetëm me shumë derdhje gjaku. Prej atëherit e deri në luftën Ruso-Turke, që e pat përfundimin e mramë me traktatin e Shen Stefanit dhe të Berlinit, e që fillon shkatërimi dhe copëtimi i tokëve të Turqisë, Shqipnija nuk paraqet ndonjë ngjarje për t'ë shenue. Zani dhe fjala e sajë nuk janë të ndigjueshme. Të drejtat komtare e të tjerë popujvet me qenë se janë të ndihmuem prej Rusisë, mirën parasyshtë në Ballkan.

Kjo përmbledhje e shpejtë e historisë së njoftun të Shqipnisë që është prej dymijvjeçare, është e nevojshme deri sa –sikurse është thanë –të vyejnë për me i caktue disa elemente të domosdoshme të kombit të shqiptarëve, të cilët e rrujnë akoma sod, në rrahjen e problemeve komtare, një tashmëni të gjallë të tyre. Rizulton sidomos se kombi shqiptarë është një racë me të vertetë auktoktone ndëper vendet ku akoma gjendet e banon, për mrenda kufive gjuhuër. Sundimi i zaptuesve sllav, -e ktu nuk flitet për ndo'ë sundim kurrë nuk ka ngja mbas Bizantinëve –është qenë fare i përkohshëm e copa copa edhe as një herë në qetsim, për gjithmonë në ngacim e në vrasje me qindresa kundërshtarë të shqiptarëve.

Si tokë e nkryqzimit të rrjedhjeve të ndryshme kundërshtarë, lodërdinë e shesh i gjanë i shumë fituësve t'ashpër, e damun dhe e therorizueme midis ambicjesh dhe luftnash të tyre, Shqipnija nuk mujti me kristalizue një njësi të qëndrueshme politike e cila të përgjasohet në njësinë e vet komtare: ka humb tokë etnografike, sidomos ndëper kufitë prej gërvishtjes e grabitjes e, edhe prej shtypjes së të tjerë popujvet: është damun në tri faltore të ndryshme, katolike, ordhodokse dhe muhamedane; dhe kjo është pasqyra e të tri kurrentëve që e përshkuen; për me gjithë kte ka mundun m'ë rrujtë, ndëper shekujt dhe ndëper ngjarjet ma të ndryshueme, thellsinë Komtare të pa përlyeme dhe të përbashkët, e cila i jep një individualitet fizionomisë së saj dhe racës së saj në histori.

Prova e ksaj njësisje është bashkëvertetue nga historija e jetës dhe nga veprat e Skenderbegut. Kur është dale një Kryetarë, i fortë, me auktoritet, i zoti për me i komandue, partitë ose anët e thymë o të munduna, qytetet e fiset e shpërndamuna, janë mledhë me'ë here në një trup fuqisë me karakter komtarë. Ngjarja, ose ndryshimi i popullit shqiptarë është qenë prandaj mu sikurse i çdo populli ballkanas, me lëvizje njëna pas tjetrës të shkëlqyeshme dhe të humbuna, të cilat zbashkuten masandej u shuen prej sundimit turk.

Ma në fund duket e qëndrueshme dishira e Shqipnisë për m'ë lypë një bazë të mprojtjes kundër kërcënimeve, lakminave e përdhunive të zaptuesve, për pos fuqive të

veta, pertej brigjeve të detit, ose n'Itali. Kjo dishirë, ose prirje spjegohet jo vetëm me maredhanjet ose me të hasunat në mes të dy brigjeve t'Adriatikut, por me një shtytje të përbashkët komtare, natyrisht jo perulse njena ndër tjetren, të popujvet shqiptarë, i cili ndër të gjithë popujt e Ballkanit i vetmi ishte që nuk dinte m'e gjetë ndo'i pergjasë nde ndo'i pështetje interesi edhe kshtu njifte ndër italjant ose ndër okçidentalt e kulturës latine pertej detit, miqt dhe perkrahsit natyruer të vetit. Ky fakt, shumë me randësi, perban e formon një element të ri t'individualitetit komtarë të Shqipnisë.

PREJ TRAKTATIT TE BERLINIT ne luften evropijane

Traktati i Shen Stefanit dhe aj i Berlinit, qi plotsojnë qellimet e veta kundër turqvet, perfaqsojnë hymjen e rrebët të politikës cariste të Rusisë në Ballkan. E frymzueme per luftime të pa kufizueshme kunder armikut të vet shekulluër, Turkisë, ket politik per s'parit e frymzon tuej e realizue në të dy traktatet, per m'e paksue sa ma shumë token e Turkisë dhe kshtu per me i zmadhue ne maksimum tokat e shteteve të reja orthodoxe të Ballkanit, të cilt lindeshin mbishkretimet e para të Perandorisë Otomane të ndihmuem prej Rusisë se ishin vasalt e saja, me sherbimin e të perhapunit të saj porantorike dhe kshtu fillon shkatrimi i Turkisë, i cili bahet me një herë edhe cingullimi i Shqipnisë, e pandehune jo si një entitet etnografik autonom, por vetëm sikurse një permledhje o shumë e provinçeve të Turkisë; me gjithë qi vet Turkija qyshë më kohë i kishte rregullue administrativisht, si një njisim të shquem fort mirë nga pikpamja komtare, banuest shqiptarë në katër vilajete: të Shkodrës, Kosovës (Shkup), Monastirit dhe të Janinës.

Në ket mëndyrë, tokët thjeshtisht dhe me shumicë shqiptare të Vranjes, Kurshumlisë, Nishit, Leskovaqit, i shenohen Serbisë, dhe në tjetren anë Malit të zi i'a aneksojnë krahinën, edhe kto krejt shqiptare – të Podgorices të Triebshit dhe viset e Gusisë e Plavës, të cilat ma vonë si mbas qindrimin të fortë të shqiptarvet, shkëmbehen me qytetet e brigjeve të detit, dhe kto shqiptare d.m.th. t'Ylqinit dhe të Tivarit: në tjetren anë Grekija merr në zaptim viset e Artës. Ma shumë se njëqindmij shqiptarë si mbas traktatit të Berlinit kalojnë ndër sundimin e Serbisë. Por se Shqiptarët nuk paten perkrahes, as per njoftim t'individualitetit komtarë, dhe aq ma pak, per therorië ose per hirin e një të drejtes se tyne toksore.

Tash historija e Ballkanit e shekullit XIX e cila shef themelimin e shteteve mvehte të komsinave Krishtene, e provon qi as njena prej ktyne vendeve nuk mujt me u lirue dhe me u pohnue per pa një ndihem nga ana e fuqive të mdhaja t'Evropës. Ksodore ka ndodhë s'parit per Grekinë, të cilen e favorizoj Britanija e Madhe dhe ma vonë per Serbië e Bullgarinë qi i mprojt Rusija e Carvet. Shkatrimi ose coptimi i parë i Turkisë, formimi i shteteve të reja, ma shumë se per me ndjekë një rregull të parimit me të vërtetë komtarë, asht ba në rangimin e njëj politike t'Evropes per kunder Turkisë. Ne ket lojë politike e cila perseritet ne vjetin 1913 dhe masandej per mbas luftës evropiane, nuk gjindesh vend per një të drejtë komtare të Shqipnisë së perveçue.

Por prej Kongresit të Berlinit (1878) asht qi formohet per reaksjon të vendimeve që nuk i'u njoften as ndo'i të drejtë komtare shqiptarve, një levizje e re e rivendikatave dhe e kërkesave shqiptare – e cila asht e para qi ka pasë një karakter të plotësuem dhe qi ka mundun me paraqitë n'akt një ndërjegje të njëjtë të Shqipnisë veriut dhe të jugës, te brigjevet të detit e të mrendëshmes dhe veç ktyne me i paraqitë dasitë lokale e ndryshimet fetare: kjo dukumenjon qenjen reale të njëj komsje, e cila nuk asht as sllave, as greke, dhe as turke, qi ishte aq dendun e strukavun në mes t'Adriatikut, Malit të zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Grekisë –dhe kshtu m'e themelue me të vërtetë fillësën e njëj kohes së re në historinë e Shqipnisë.

Kjo lëvizje qi duhet vemendsisht m'e konsiderue, u ven perballë Fuqive të mdha t'Evropës, lakmuesve të vendeve ballkanike edhe po vet Turkisë, një problemë të konkretshme të komisisë shqiptare n'etniçitetin e vet etnografik, n'kufitë e sajë gjuhsuër si dhe në dishirën e vet per njësimin e indipendecen politike. Qysh prej atëherit, mund të thohet, qi u caktue programa, kan vazhdue pa premun deri më sod kryengritjet shqiptare, të cilat – likuidimi i luftes tuej mos i shpague e knaqun –i ka helmue, dishprue e ndezun ma tepër.

Lëvizja nisë me mledhjen në Shqipninë e sipërme dhe të jugës: në Shkodër, Prizren, Prevezë, Janinë, e në të tjera qendra ma të vogla, per me i kundërshtue në veri lëshimit të tokave shqiptare Serbisë e Malit të zi, e në jugë kërcnimeve dhe lakminave të Grekisë.

Aty kah mbarimi i vjetit 1878, ndëpër të gjitha viset e Shqipnisë, ndezet dishira e ideja e Atdheut, por kte asht vështirë m'e shfaqë botnisht, me qenë se Perandorija Turke, kishte një sundim të fortë e të kujdesëshëm në viset e Shqipnisë së jugut dhe të mesmes. I vetmi vend ku Turkija nuk e kishte një influencë aq të madhe, ishte Shqipnija e veriut, sidomos Prizreni. Prandej fillojnë mledhjet lokale nëpër krejt qytetet me randësi të Shqipnisë, per me i que delegatët në Prizren ku do të bahesh botnisht Kongresi i pergjithshem komtar i Shqipnisë.

Nga mledhja e Shkodrës dergohet një dergatë ndër kryesë të derës Gjon Markaj, të Mirditës; prej mledhjes së jugut qi bahet në Gjinokastër, si kryetarë të dërgatës çohen Abdyl Bej Frashri dhe Mehmet Ali Bej Vrioni; dergata e Tiranës dergohet e kryesueme prej derës Zogu nga Mati; dhe kshtu vijoje të tjera qyteteve të Shqipnisë. Ky Kongres i pergjithshëm komtarë, quhet *Lidhja e Prizrenit*. Ktu me një herë vendohen tri pika: a)trajtohet programa e autonomisë komtare shqiptare; b) caktohen kufitë etnografik të Shqipnisë; c) caktohen masat per punimin e mrendëshem dhe nderkomtarë.

Per punimin e mrendëshem caktohet Komitet Qendruer i fuqive komtare per mprojtujen komtare të vendit, i formuem prej Sulejman Vokshit nga Gjakova, prej Haxhi Zekës nga Peja dhe Omer Korenicës nga Prizreni. Per punimet nderkomtare *Lidhja e Prizrenit* dergon perjashta dy mis të vet: Abdyl Frashrin dhe Mehmet Ali Vrionin, te cilt, per zbatimin e programes të trajtueme dhe me konsensin e krejt popullit të Shqipnisë, vizitojnë Romen, Parisin, Londonin, Vjenën dhe Berlinin. Por, mjerisht, me qenë se Rusia ishte e fortë, kërkesat komtare të *Mledhjes së Prizrenit* të bamuna me anë të delegatëve të vet, nuk u muerën parasysh nga Kongresi i Berlinit. Programa e Shqipnisë pershinte tokën e krejt vilajeteve të Janinës, të Shkodrës, dhe zonat me një shumicë të madhe shqiptare të Vilajetit të Shkupit dhe të Monastirit, tuej

i përshimun edhe kto dy qytete. Të katër vilajetet do të formoshin një njisim të vetëm administrativ, me Kryeqytet Monastirin, dhe gjuha zyrtare do t'ishte Shqipja.

Lidhja punon gadi dy vjet, e fillon zakonisht një jetë komtare të konkretëshme dhe autonome, mbjell faren e Shqipnisë indipendente. Por se dergimi i një delegacioni të tillëshëm përjashta, dhe punimet e mrendëshme aq komtare të shqiptarëve, nuk pajtohen aspak me interesat e Turkisë. Dergata shqiptare nuk guzon ma me u kthye nga s'jashtmit pse Sulltan Hamidi e shuen me armë lëvizjen shqiptare. Një ushtri prej 40.000 vetash, nder Komanden e Dervish Pashës u dërgue në Shqipni. Luftat qenë të rrepta; gjashtmdhet pashallarë u vranë në Gjakovë, prej të cilvet shenohet Abdullah Pasha, shqiptarë por në shërbimin e Turkisë. Fuqitë Komtare të Shqipnisë të përbame gadi prej 10.000 vetash, mbas suksesit të parë qi patën, me qenë se ishin t'armatosun dhe keq t'ushqyeme, me njëherë vehen në heshtje.

Komandantët e tyne, Sylejman Vokshi dhe Omer Koronica internohen prej turkut dhe vdesin ndërper burgjet e Perandorisë Otomane, dhe Haxhi Zek Peja qi i shpeton ndjekjes së turqvet, ma von vritet prej Zajmit të Pejës me paret e Serbisë. *Lidhja e Prizrenit* kshtu prishet dhe lëvizja autonomiste shqiptare shuhet ndër tokët e Turkisë. Por se në ket fazen e parë të punimit dhe të veprimit të vet e ka shque dhe e ka shfaqë prodhimin dhe frytin e sajë. Gusija e Plava qi i ishin shenuem Malit të Zi, i kthehen Shqipnisë e cila i permban e i ruen ende, Prevezen e Janinën të kerkueme prej Grekisë. Por ktu, per mi të gjitha, e sidomos, asht hedh fara e njëj shkendijes së re shpirtnore per rilindjen dhe lirimimin shqiptarë.

Lëvizja komtare e shqiptarve qi, ktu tash ma, ka marr një karakter të dukshëm irredentist, vazhdon me forma ilegale dhe kerkon themelet e veta, me të tjera manifestata, pertej kufive të Turkisë, nder të tjera vende ballkanike.

Qysh prej vjetit 1879, themelohet në Stamboll *Shoqnija Letrare Shqiptare* e cilla perfshinë në vedi muhamedan, katolik e orthodox edhe proponohet me lavrue gjendjen e pikpamjen shpirtnore të lëvizjes komtare shqiptare. Ajo me të shpejtë boton një abatare dhe një libër të këndimit shqip, zhvillon e ngashnjen nximin e gjuhës shqipe, boton revista letrare dhe nxime të ndryshme. Ma von aktiviteti i ksajë Shoqnije, e ndjekun dhe e kontrollueme prej qeverisë turke, transferohet në Bukuresht, në Bruxelles, në Sofje, tuej botue brozhura e shpallje të cilat dergohen mësheftazi në Turki për të i'u shpërdarë shqiptarvet. Duhet mos t'a harrojmë se gerrat e të gjitha ktyne shpalljeve dhe botimeve nuk janë ato të turqve, as ato çirillet e serbvet dhe as të helenvet, por vetëm e vetëm latine. Në të katër shekujt e mramë sikurse per katolik, ashtu per orthodox dhe per muhamedan –njisimi i shkrimit i cili nuk eksiston akoma sot në Jugosllavi ndër serbt, kroatët, dhe muslimant e Bosnje-Hercegovinës dhe të Maqedhonisë. Gjinden vllime librash me shkronja latine qysh prej shekullit XV e edhe prej shekullit XIV. Edhe kjo e mëndyrës së shkrimit asht një tjetër shenj e karakteristikave tipike të mvehtësisë ose t'individualitetit komtarë të popullit shqiptarë qi e dallon nga të gjith popujt e tjerë të ballkanit dhe qi e bashkon me latint, ose ma mirë, me okçidental.

Shoqnija letrare shqiptare prandaj nuk ka shpikë as gja prej vedit si krijim të ri në gjuhen shqiptare vetëm e ka lavrue nximin e zhvillimin letrarë. Kjo rilindje e gjuhës së vendit nuk asht në shekullin nandëmdhjetë, një fakt vetëm shqiptarë. Gjindet në Finlandë ndër finlandezët të cilt per mbi svedezt e kan shumicen per kah numri e tash ende krejt qeverija dhe kah fillimi i shekullit të kaluem nuk njëfishin gadi krejt ma një

gjuhë të vetën të shkrueme të cilën mandej e rigaditën me vepra të letërsisë dhe me studjoz edhe kan mrrij tash qi kte e kan gjuhë zyrtare të Republikës së re. Gjendet dhe në Jugosllavi, midis sllovenvet, ku deri tash dhjet vjet bahet, në sundimin Austriak, nuk gjendesh ndo'i gramatikë sllovene.

Nji tjetër shfaqje typike e lëvizjes komtare të shqiptarve në ket kohë asht perpjekja e zonave orthodoxe per krijimin e nji kishe autoqefale me perdorimin e gjuhës shqiptare. Kjo perpjekje –ose lëvizje, qi vazhdon deri n'agimin e luftës ballkanike, themelon në Korçë një lidhje *Lidhja Orthodoxe*.

Bashkimi orthodox u përhap n'Elbasan dhe në Berat, per me u lirue nga Patriku ikumenik i Grekisë në Konstantinopojë. Kshtu, me gjith se ngelin besnik të konfesjoneve tradicionale të tyne, viset orthodoxe të Shqipnisë, nuk doshin me pasë përzimje me kishat e grekve, të serbvet e të bullgarvet, me gjith se janë orthodox. Kushtetuta e re Turke në 1908, rregjimi i djelmnisë turke, dhanja e disa lirive të rrejshme suellën dyshim dhe nji zgjim të turbullt ndër të gjitha krahinat shqiptare. Prandaj fillon të rilulzojë programa e tridhjetë vjetve ma perpara mbi autonominë. Formohen shum Klube komtare ndër të gjitha qendrat e Shqipnisë, por sidomos ndëpër viset e kufive gjuhsore, në Shkodër, në Shkup, në Florinë, në Mitrovicë, në Manastirë, Korçë, Janinë dhe ndëpër qytetet e tjera ma të vogla per me organizue nji jetë botnore komtare të shqiptarve dhe me i qindrue shembëllisht sa programës qi i turkizonte qeverimi i Zhon turqve, aq propagandës dhe përpjekjeve, qi qilloyshin shrranjosten komtare, të serbvet, të grekvet dhe të bullgarvet, mrenda në tokët e Turkisë.

Njiqind shkolla shqiptare, të mbajtuna me të holla të shqiptarvet, u themeluen me pak muej. Themelohen gazeta e tipografina per botime të librave didaktike. Tri kongrese të mdha komtare, ku marrin pjesë përfaqësuesit e çdo Klubi, mledhen njeni pas tjetrit në Monastirë, Dibër dhe Elbasan, per me ripohnuë të drejtën komtare shqiptare, dhe vijen e kufive etnografike, si edhe me i organizue shkollat. As nji gja e tillshme nuk pat ngja per mbrojtjen e ndonji të drejte të serbve ose të grekve ndër tokat e Turkisë të cillat u janë qenë shenuem, n'emen të njej të tillë të drejte të pandehme, Serbisë e Grekisë, tue i'a këputë padrejtsisht Shqipnisë. Bile grekt e serbt atëherë bashkoheshin me turq, per m'e protestue ket levizje komtare irredentiste shqiptare.

Reakcioni turk asht i shpejtë: prap e shtyp me fuqina t'armatosuna. Tre gjeneralat, Xhavit Pasha, Shevqet Dergut Pasha dhe Fadil Pasha, dergohen në Shqipni në krye të nji fuqisë shum të madhe, per me luftue shqiptarët e Kosovës, të Shkodrës dhe të Lumës.

Mbas shum luftimeve të pergjakshme, prap fuqit e mdha ushtarake turke, fitojnë; por se nji shumicë e madhe prej parisë shqiptare të vendeve të ndryshme ikin e dalin jashta Shqipnisë. Por n'agimin e luftave të para ballkanike, prap shqiptarët e Kosovës dhe të malsinave të Shkodrës i fillojnë lëvizjet e tyne komtare. Atëhere fillojnë me hy mrenda në Shqipni t'arratisun nga Turkija dhe mledhun të gjith intelektualt dhe pariya e mrendëshme në kuvendin e quejtun *Mledhja e Junikut* e cila u perfundue me *Lidhjen e Beses te Verrat e Llukës*. Prej ktu mësyhet Peja dhe Gjakova, të cilat menjherë u dorzohen fuqive shqiptare; në ket mëndyrë dorzohen Prizreni, Kaçaniku, Mitrovica, Prishtina dhe zaptohet Shkupi, prej kah –per m'e pushue luften –shqiptarët i shpallin konditat e veta komtare e politike, të cilat mbas rrëximit të

qeverive turke, qeverija e re e Ahmet Muntar Pashës dhe ma vonë e Qamil Pashës, i pranojnë plotsisht.

Por ngjarjet shpejtohen. Formohet *Lidhja ballkanike* dhe pelset lufta kunder Turkisë. Kjo luftë, qi sjell një shkatrrim e coptim të ri të Turkisë dhe të tokavet thjesht komtare të Shqipnisë, asht pas qenë e pergatitme dhe e favorizume prej kryengritjeve e luftimeve fituese të shqiptarvet, të cilat e kishin dobsue ushtritë turke. Prandej lufta ballkanike nuk asht tjetër vetëm se një vazhdim i luftnave shqiptare. Sido qoftë përfundimi asht i shpejtë.

Nëper kujtimet e veta Kryeministri i Bullgarisë Iv. E. Geshoff (*L'Allince ballkanique* Paris 1915 faqe 82) shkruen: “Ksaj kujdesje e ktij frigsimi (per bashkatdhetarët e vet) i shtohesh sa në Belgrad aq në Athinë friga qi inspirohesh prej kerkesave të shqiptarve”. Fjalë të sakta e të caktueme të cilat shenojnë karakterin e luftës së parë ballkanike, i cili qe i ideum, i munduem dhe i luftuem prej serbvet dhe grekvet: jo vetëm lirimi i bash-atdhetarve të vet nga sundimi turk, por të përhapunit imperialist mbi një tokë të huej që u përkiste shqiptarve të cilve qysh me kohë doshin me i’a u ndalue pohimet e tyne komtare definitive.

Kjo e vertetë asht pohuemun nga observetort amerikan të pa anëshem: “Serbt janë ngutun shum me i kundershutue njej planit të njej *Shqipnisë ma të madhe* me planin e tyne të coptimit të Turkisë n’Evropë në mes të shteteve ballkanike në katër qarqe t’influencave”¹.

Në vjetin 1912 pra, Serbia, Bullgaria, Greqija dhe Mali Zi i hapin luftë Turkisë. Pak ditë ma vonë, në Vlonë, perfaqesuesit e të gjith viseve të Shqipnisë, të mledhun në Vlonë, shpallin indipendencen Shqiptare, me kufitë gjithmonë të kërkuem.

Me luftën ballkanike të nandet pjesë të tokave ku flitet gjuha shqiptare janë të zaptume prej Malit të Zi, Serbisë, e prej grekve, me një program të zaptimit të përqëndrueshëm, i cili nuk i len as ndo’i vend të drejtës komtare të Shqipnisë. Ky program, të cilin me të vërtetë mund t’a quejmë imperialistë, shfaqet sheshazi në punimet e operacioneve ushtarake. Mbasi u zaptue Shkupi, me ndihmen e fiseve shqiptare të Malsorve, komanda ushtarake serbe urdhnnon ndëper tër anavendet masakrime sistematike kundër shqiptarve, tue aprofitue prej shtet-rrethimit të tij absolut qi i permban të gjithmonëshëm dhe prej njij kontrollimit fare të lehtë ndërkomtarë, per me paksue nga statistikat etnografike të vendit dhe m’e rruhdhë në një gjendje të pakeseshme shumicën e popullit shqiptarë. Nuk i kursen as pleqt dhe as gratë. Krejtsisht katunde janë plaqkitun dhe shembun e shkatrrue me zjarrm.

Numrohet qi ma shum se 130 mij shqiptarë janë qenë të mbytun prej serbvet n’at kohë. Kjo shpjegohet prej ndryshimit të ndjenjave të shqiptarve, pse malsorët, qi i paten ndihmue Malit të zi në luften e Kumanovës, e cilla qe e fundit qi n’anen e Serbisë do të përfundonte luften ballkanike, tash ngrihen perseri dhe u kundërshtojnë rrebtësisht atyne në rrethimin e Shkodrës. Kurë Serbia zbriti në Tiranë, në Durës e Elbasan, në Mat nuk muejti me hy, sepse matjant, të komnduem prej A. Zogut, luftuen gjashtë muej rresht.

Shpirti qi e sundon Konferencen e Londonit të 1913, me të cilen likuidohen luftnat ballkanike, , asht po aj qi e ka pasë drejtue Konferencën e Berlinit: m’e paksue në minimum token e Turkisë, në të cilen ishte e pershime edhe Shqipnija; m’e rritë e

¹ -Raport of the International Commission o inquire into the causes and conduct of the Ballkans Wars “Carnegie e dowement for international Prace –Washington 1914 faqe 47.

zmadhue në maksimum token e të tjera shteteve ballkanike, të pandehuna mikneshe, në sherbimin e popullatës së përgjithëshme të disa Fuqive të Mdhaja dhe sidomos të Francës dhe të Rusisë. Me ket shpirtë, vetëm për vetëm negativ, u krijua Shqipnija e parë në mvehte.

Me art. 3 të traktatit të paqit të Londonit, më 30 Majë 1913, Turkija u ep të drejtë të gjasht Fuqive të Mëdha për me i caktue kufitë e Shqipnisë dhe me i zberthye të tjerat çështje qi janë të lidhuna me kte. Por, përveç Italisë qi tërhiqesh e përfaqsohesh prej Austro-Ungarisë, as ni ndihmesë nuk e pat komi shqiptarë. Kshtu edhe një herë Shqipnija u therorizue dhe randsisht u cungullue.

Pretendimet e shteteve të ndryshme ballkanike kufizues mbi tokët shqiptare –pasqyrë e natyrës së vërtetë të politikës së tyre –ishin tepër shtytse; aq sa, me gjith qindrimin e fortë të përkrahësve, Konferenca e Londonit dhe vepra e pastajme e komisionit nderkomtarë për caktimin e kufive të Shqipnisë doshin randsisht me i zvoglue, kufitë shqiptare.

Serbija knaqesh me zonen e gjanë dhe të begatshme të lindjes së Shqipnisë, por donte me ndejë n’Adriatik, në Durës –ku ishte ardh ma përpara –dhe donte me ruejtë një pjesë toke si udhë të lidhjes. Mali i Zi pretendonte zaptimin e krejt krahinave të Shkodrës, zbashkut me qytetin, deri në lumin e Drinit. Grekija pretendonte zaptimin e të gjitha tokave jugore të Shqipnisë deri në lumin Semen.

Tokë prandaj thjesht me gjuhë shqiptare, qytete qi janë qenë vatra e irridentizmes shqiptare –sikurse asht dokumentue nga shkoqitja e shpejtë historike ktu të plotsueme –në ket mëndyrë do të duheshin me kalue nga sundimi turk në një sundim të ri të huej. Protokoli i Firences, më 17 Dhetuer 1913, e ban vetëm një drejtësi të vogël të ktyne pretendimeve të gënjeshtërtë. Mali i Zi nuk e merr Shkodren, por merr Beranen, Rozhajen, Pejen, Gjakovën, Plaven, Gusinë, Hotin, Gruden, Tuzin, e të tjera qendra ma të vogla, me popullsi prej afër 250.000 mij shqiptarësh. Serbia shterngohet me dhanë dorheqje prej Durësit, por merr Prizrenin, Prilepin, Mitrovicën, Dibren, Prishtinën, Gillanin, Shkupin, Tetoven, Kumanoven, dhe të tjera qytete e qendra. Grekisë i duhet me i paksue lakmitë dhe ambicjonet e gjana të veta të zaptimit, por mban Janinën.

Me gjith ket cungullim të shemtueshem të Shqipnisë, shtetet ballkanike nuk janë ngopë akoma.

Posaqrisht, sikurse Serbia, asht e unëtshme Grekija. Në Gjinokastër e themelon, në Mars të vjetit 1914, një qeveri autonome e cila quhet Epirote dhe pa-mversisht nga Qeveria e Athinës për m’e pohue akoma, mi qytetet dhe në krejt Shqipninë e jugut, me gjith se i’u kishte refuzue nga fuqitë e mdha, një të drejtë komtare të pretendueme si greke. Kjo qeveri kryesohesh prej një ish ministri të punëve të jashtme të Grekisë, Zografos, dhe ky asht i përmbajtur e i ndihmuem prej oficerave dhe prej ushtarve veçanrisht prej Krete, t’ardhun nga Grekija.

Kjo qeveri tuj u kundërshtue vendimeve evropjane dhe qeverisë së re shqiptare, e cila shpejt e përngutsisht po sa ishte themelue, plaçkitë, vret, dhe ndezë tokët e Shqipnisë jugore, ndezen flakë nga grekt qytetet e Leskovikut, të Tepelenës dhe mjerohet kryekput krahina e Kurveleshit; ktu diftohet kjartazi qi me kto shemtime e djegje grket vet-vetiu e kan pohue se kto vende nuk janë as pak pjestare t’asajë të drejtës komtare qi ata e androjnë. Kshtu tue qen të primun prej një oficeri grek nga Kreta, kolonel Jorgj Zontos Vardhas, me ushtarët e tij grek –të njoftun nga oficerat Olandez

–prishen e shkretuen gati krejt katundet shqiptare, dhe gati treqind prej tyre, të viseve të Korçës, të Gjinokastrës, të leskovikut dhe të Skraparit, tuej i shterngue qi t’ikun popullsija; e ata qi nuk mujten me ikë të gjith u masakruen.

Qytetet e Vlonës, të Beratit dhe t’Elbasanit, në ket kohë, u mbushen me refugjat, të ngelun pa mbulojë dhe pa as një mjet jetese. Vetëm në Vlonë n’at kohë paten mërrij 60.000 veta.

Ky asht një sistem i ri i grekvet, të cilin kta e persrisin po n’at mëndyrë sikurse qe perdorue prej serbvet dhe malazezvet në kohen e luftave ballkanike per kundër banuesve të Kosovës, të cilin sistem prap e perserisin mbas ndryshimit të padrejtë e të mkatshëm të fizionomisë etnike të një pjese shqiptare; dhe kjo ishte m’e ç’farosë qenjen e popullit shqiptarë per m’e pohue n’ato vende një të drejtë komtare të re të huejen.

Në ksisoj gjendjesh të vështira nuk ishte e lehtë per Shqipninë me t’u ba ballë valvet dhe mësyemjeve të luftës Evropiane. Atëhere kur kjo pelset dhe në Nanduer 1914 Princ Wiedi ikë, per pa e lan as një organizim të duhun në Shtet, themelohen në Shqipni gjashtë rregjime të ndryshme të krijueme prej shtytjes per mbrojtjen e ruejtjen vendore. Në Durës e në Tiranë sundon Esad Pasha. Katolikt e muhamedanët në harmoni të pashembëllt themelojnë një qeverim të vetin vendor në Shkodër; dhe n’anaen tjetër Mirditasit dhe Malsorët ruejnë autonominë e vet të maleve dhe kanunet e tyne. Shqipnija e jugut akoma ishte e zaptume prej grekvet; por se në Vlonë ishte themelue, sikur në Shkodër; një komitet venduer i qeverizimit.

Në ket kohë asht qi, Tetor 1914, zbret Italia në Vlonë me një mision shëndetsuer dhe masandej –tuej i mungue misjonit të vet ndihmës e përkrahës të Shqipnisë indipendente –i zbret detarët e vet në ishullen e Sazanit. Por menjher mbas ksaj Grekija, tuej fillue veprimin e vet zaptues –të cilin po sa e kish pushue –shkarkon 1.200 veta në Sarandë, zaptun dhe krahinat e Permetit e të Gjinokastres, dhe në ket kohë Venizelosi deklarun në parlamentin e Deputetve se Grekija do të vazhdonte m’e adminstrue Epirin. Kuptohet mirë fillit se serbët dhe malazezt, sidomos atëher kur u dukt sheshazi se Italia ndërhynti, i’a filluen ma tepër per me ba luftë Shqipnisë dhe me vazhdue në zaptimet e tokëve shqiptare se me luftue kundër ushtrisë Austro-Ungare. Mbi ket pikë mjaft me randësi akoma nuk asht ba ndo i kjartsim i plotë e i duhun. Por me gjith kte duhet dijtun –si fakt ma se ndriçues –hymjen e ushtrisë malazeze në Shkodër, çështjen e Konsullit Austro –Ungarik Kalla, i cilli e kishte veshtre e asistue qetsisht parakalimin e malazezvet, ndëpër lulishtat popullore, e qi mundi me ikun prej Shkodre me të gjitha nderimet e duhuna, dhe bile qe musafir në Pallatin mbretnuer në Cetinë, prej kah, me të gjitha nderimet, u shpue me automobtilin mbretnuer në Kotorr.

CUNGULLIMI I FUNDIT

Në likuidimin e luftës, lakmitë e shteteve ballkanike, qi i kan pushtue krejtsisht viset shqiptare, dalin në shesh përsëri me prepotencë. Kto lakmina t’untshme tregohen qysh prej vjetit 1919 ndëper memorjalet e tyne të paraqituna në Konferencen e Paqit, por se kto preteze rrëxohen në Qershurë të vjetit 1921, atëherë kur Konferenca e Ambasadorve, si mbas misjonit të marrun nga qeverinat e tyne, merr m’ekzamim

çeshtjen shqiptare. Ktu bisedohesh per m'e krijue rishtaz nga themelet Shqipninë në kufit e saj politik.

Italiya pushton Vlonën; Serbija e cilla në janarin e 1920, kishte deklarue me hekë dorë nga çdo kërkesë toksore mbi Shqipninë, në vendin e vet shtjen Malin e Zi për me kërkue pushtimin e viseve të Shkodrës dhe pretendon akoma (*gjoja për arsylene strategjike*) retifikimin e kufinit të 1913 qi ndëpërhynë thellsisht në dejt ma të shëndoshë të Shqipnisë. Bullgarija nuk merr pjesë. Grekija kërkon Korçën dhe krejt zonën jugore të Shqipnisë, të cilën, per me ngatrrue me pozita e idena ajo e quen Epir i eper. Prandaj Shqipnija e 1913-tës do të psonte cungullime të reja.

Por kundër ktyne programeve dhe coptimeve të Shqipnisë dhe të shqiptarëvet, me memorjale të ndryshme, zyrtare dhe qeveritare, dergatat dhe Shoqninat e ndryshme shqiptare ndëpër botë, paraqesin në Konferencen e Paqit, e ma pastaj qeverinave të ndryshme të mdha, ate qi asht e drejta aktuale, komtare dhe toksore, të popullit shqiptarë i përbamun në njësi politike indipendente.

Shqipnija kerkon një kufi etnik. Ky kufi qi asht ma shum i zvogluem e i rrudhun se siç i ka kufitë e natyrshëm, të cilat i kemi trajtue qysh në fillim të ktij studimit t'onë mbi gjurmat e shfaquna po prej gjeografistit sllav, nisin prej Adriatikut në veri të Tivarit, prej grykës së Shpuzës (Spitza): tuej pershkuë në drejtimin veri-lindje dhe tuej perfshimun krahinat e Tuzit, Hotit, Grudës dhe Triepshit, deri në qytetin e Podgoricës, i cili mbetet permrenda kufive t'onë: vijon rregullisht kufitë e Malit të Zi perpara vjetit 1913, dhe përfshinë provinçen e Pejës (Gjakovë, Plavë, Gusi, Beranë dhe Rozhajë), zonën orientale të krahinave të Mitrovicës, krejt provincën e Prishtinës dhe krahinat e veta: Vuçiternë, Gilan, Ferizoviç, Kurshiumli, dhe një pjesë nga krahinat e Shkupit, të katër krahinat e Tetovës (Kallkandelenit), Gostivarit, Kerçoves dhe Dibres; vazhdon tuej pershkuemun ndeper viset qi gjinden në mes të liqenit t'Ohrit dhe të Prespes' nga ktu ndjeket vija e kufinit të trajtuem në vjetin 1913 deri në malin Gramsh (Gramos) dhe vijon kah juga tuej mbarue në gryken e Prevezës.

Kta janë kufitë e vërtetë ma të pakët qi Shqipnija i kerkon dhe do t'i kërktojë kurdoherë pse kta caktojnë thjeshtësisht e pa ndo'i kundërshtim vendet e saja komtare e historike: në të cilat edhe në përkshimet e shum ngjarjevet historike, si shkretnime dhe masakrime, populli i saj ka mundun m'e ruejt të pa perlyme, sbashku me shumicen numrore absolute, individualitetin e vet etnik e gjuhsuër.

Per mrena ktyne kufive jetojnë dy miljun e gjysëm shqiptarë, me shumicë të madhe s'paku 80% ndëper të gjitha vendet, mbi popullsinë sllave ose greke, shumicë e cila hypë në 90% e deri në 95% ndeper krahinat e Pejës, Gjakovës, Prizrenit, dhe të Çamërisë.

Por me kta kufi anulohen dhe zhduken të gjitha lëshimet toksore shqiptare të bamuna serbvet, malazezvet dhe grekvet prej Kongeresit të Berlinit në 1878 dhe prej Konferences së Londonit në vjetin 1913 qi e kan sakrifikue ndër sundimin e huej ma tepër se një miljun e gjysëm shqiptarë, ose ma mirë me thanë, ma shumë se gjysmën e popullsisë së vërtetë shqiptare qi kishte mbetun.

Kjo natyrisht nuk do të pajtohesh me shpirtin e Konferences së Paqit. Po ato parime qi per –sa i perket çeshtjes shqiptare, e konsiderueshme jo në vet vedi, në të drejtat e vata natyrore e komtare por se në veprim të njëj lodres politike të gjanë dhe të ngatrrueshme të Fuqive të Mëdha –paten sundue e influencue në Kongresin e Berlinit,

ashtu edhe në Konferencen e Londonit më 1913 perseriten prap ne zhvillimin politik të luftës Evropiane, në Konferencen e Paqit dhe n'ate ma vonë t'Ambasadorve.

Qysh në kohën e luftes Evropjane flitesh një coptim i Shqipnisë për me i'a ba një dhuratë të madhe Grekisë si shpërblësë për marrjen pjesë në luftë, që pritesh sa ma shpejt. Ky propozim që bamun më 23 Nanduer 1914 prej Sazov-it, ministrit të punëve të Jashtme të Rusisë t'asaj kohe, i cili i kundërshtoj kërkesës italiane për një Shqipni indipendente, në bisedimet e Paktit të Londonit: ky fakt asht zbulue prej botimeve të mshefta të luftës që janë shkruar në Librin e Zi të qeverisë Bolshevike të Rusisë. Ky mendim i coptimit të Shqipnisë përsëritet në Këshillin e Naltë të Parisit, në mledhjen e 13 Janarit 1919, ku Clemenseau paraqet një plan për pjestimin e Shqipnisë, në mes të Jugosllavisë, e cila do të merrte krejt Shqipninë e sipërme, me Shkodrën dhe bregun e detit deri në Shen-Gjin; dhe Grekisë do të i'u shenjojshin pjesët jugore me Gjinokaster dhe Korçen. Ky projekt bisedohet edhe në konferencën e Ambasadorve, atëherë kur propozohet rishtazi lëshimi i Shqipnisë jugore Grekisë për me shpërblje për që pat hekë dorë nga Izmiri edhe për të thyemunit e sajë në luftën kundër turqvet.

Një herë tjetër në Konferencën e Paqit çështja shqiptare që konsiderue vetëm në pikëpamje të kundërshtimit Italo-Jugosllav. E vetëm mbas bisedimeve që u banë në Pallanza çështja e Shqipnisë shpëtohet nga ky kombinacion.

Atëherë mirë fillit dihet se qyshë, të drejtat e dukshme komtare të shqiptarëve, likuidimi i luftës Evropjane akoma edhe njëherë, ma tepër se veprimet e ma perparshme ndërkomtare, do t'i kenë sakrifikue e cungullue viset komtare të Shqipnisë.

Shqipnija mbetesh pa as ndo'i perkrahës. E vetmja perkrahje ishte ajo e cila i vinte prej Italisë, të cilën perkrahje kjo Fuqi e pat hjekë ma parë për arsye se pretendonte Vlonen, dhe masandej pse ishte në ngushtica të mdhaja të cilat duhesh t'i perballonte për mprojtjen e të drejtave të veta komtare të luftueme nga Fuqinat tjera.

Proçesi për caktimin e kufive shqiptarë asht plotsue vetëm si mbas proçesit të caktimit për kufitë e serbvet dhe grekvet: ose as një herë nuk u konsiderue drejt për s'drejt çështja e Shqipnisë me nevojat e veta, por perkundrazi asht mendue për me i'a dhanë Serbisë dhe Grekisë kufitë që ktyne u vishin për shtat o që ktyne u pelqejshin, dhe shka mbetesh si tepricë, nga kjo metodë zvoglumi, që Shqipnija.

Po, në Konferencën e Paqit, më 7 mars 1919, dergata shqiptare lajmonte se Komisioni, i ngarkuem për punët e shqiptarve, merresh me kërkesën e Grekisë që pretendonte mbi tokën jugore të Shqipnisë, për pa e marrë as pak parasysh çështjen e rivendikatave shqiptare mbi Çamrinë e pushtueme prej grekvet. Përveç kësaj dergata shqiptare kerkonte që për të gjitha viset komtare të zaptueme prej serbvet dhe grekvet të bahesh një plebishitë. E ma vonë, më 26 Dhetuer, dergata shqiptare, me një notë të Imzot Bumçit, zbulonte dhe shfaqte për që, me gjith se nuk ka ndo'i nderim për kah të drejtat komtare të Shqipnisë, i'u epte randësi ma tepër arsyenave thjeshtë me karakter konfesjonal –Kisha Orthodoxe –në favor të Grekisë për me i justifikue cungullimet e reja të viseve shqiptare. Për mjerisht kto thirrje dhe kta zana të shqiptarvet nuk merren parasysh.

Mbasi që Konferenca e Paqit e shpjen në Konferencën e Ambasadorve detyrimin për caktimin e kufive të Shqipnisë dhe kjo i'a ngarkon me anë të njëj note komisionit të njoftun ndërkomtarë realizimin praktik, kufitë e Shqipnisë ngelin po ata të cektuem

në vjetin 1913, por me katër shkputje të reja në favor të Serbisë: 1) në krahinat e Shkodres i epet Jugosllavisë dhe mali i Veliçikut, i cili ma parë ishte i Shqipnisë, me pretendim se gjoja i duhesh për mprojtje ushtarake të Podgoricës, kjo tokë asht thjeshtë shqiptare, e cila mbas Kongresit të Berlinit i'u pat dhanë Malit të Zi dhe tash Jugosllavisë; 2) në krahinat e Pejës, i epet Jugosllavisë zona e frytshme dhe thjesht shqiptare e Junikut, e cila pat mbet *Zona neutrale* nga Qafa e Morinës deri në Lumin Bistrica dhe në Gryken e Deçanit; 3) në krahinën e Prizrenit, prap i epet Jugosllavisë një zonë e gjanë toke, me krejt fisin shqiptarë të Gorës, me pretendim për m'ë sigurue rrugën e shkuemjes në Prizren nga Perëndimi në jugë; 4) në krahinën e Dibrës i shënohet Jugosllavisë pushtimi i krejt rrugës ndërmjet Dibrës e Strugës, ndër pretendimin se gjoja siguron lëvizjen tregtare të Dibrës.

Ksodore ktu bahen kater rretifikime me randësi të cilat paksojnë ransisht çdo hov të njisimit ekonomik dhe mbrojtje ushtarake të Shqipnisë dhe veht kshtu gjithmonë ndër kontrollimin strategjik të kërcnueses e lakmueses së sajë: Serbisë.

Me gjith kte Jugosllavia nuk ngopet. Vendimi i Konferences s'Ambasadorve mbi kufitë e Shqipnisë u ba në 9 Nanduer të vjetit 1921. Por qyshë me 2 Nanduer të këtij viti qeveria shqiptare e cila kishte muejtun me ba qi Shqipnija të rinjifet dhe të pranohet në *Lidhjen e Komeve*, për të cilën gja Jugosllavija kishte ba ma të fortat kundërshtime, i shenoj Sekretarjatit tonë Gjinever se Jugosllavija kishte fillue një mësymje të re me ushtrinë dhe se kishte hy në tokët shqiptare, në zonën e sipërme, dhe sidomos kërcnonte viset e Lurit.

Me 16 Nanduer po të ktij vjeti, mbledhet ngutsisht në Paris Këshilli i Shoqnisë së Kombeve. Delegati i Britanisë së Madhe, Fisher, flet kjartaz. "Jugosllavija –aj thot-mundohet prap për me shkaktue një coptim të ri të Shqipnisë, tue i'a këputë viset e sajë të veriut. –Ajo ka ndezur një kryengritje me anë të disa kryetarvet shqiptarë të Mirditës me emisarë t'ardhun nga tokët Jugosllave.

Në midis të kryengritësve gjenden dhe janë aty edhe tepricat e ushtarve rus të Wrangel'it, qysh me kohë të mbështjellun në Serbi dhe gjenden trupa të Jugosllavisë. –Ushtritë Jugosllave, tash ma dihet, kan shkaktue dame të mdha dhe kan prishun krejt katundet shqiptare ndeper viset e pushtueme në themel t'armpushimit. –Delegti Jugosllav do me i justifikue trupat e ushtrisë Jugosllave dhe qeverinë e vet. –Për delegati i Shqipnisë, Midëhat Frashëri, po ep shkoqitje dhe lajme të sakta mbi armatiminin e Mirditasve, ndër të cilët gjenden edhe aeroplana qi natyrisht nuk do të munden me qenë fabrikim i vendit".

Atëherë, n'at kohë, Kshilli i Lidhjes Komeve i dha urdhen Jugosllavisë për me i terheqë sa ma shpejt ushtritë e veta tuej i ngrehë pertej vijes së kufinit qi ishte caktue ma përpara dhe me hjekë dorë nga çdo kryengritje në dam të Shqipnisë. Natyrisht Serbia pergatite një veprim të përgjashëm me ate qi pat ba Grekija ne Gjinokaster: d.m.th. me shkaktue një dasi lokale mbi te cilen do të ngrifte dhe do të bante një veprim të drejt për drejtshem pushtimi.

SHTYPJET OSE PERDHUNITË SERBE

Asht ardhun koha per m'e konsiderue me ma vemendje e vrejte, në pamjet e ndryshme të posaçme të saja dhe në dokumentat e vërtetë të sajë, të drejtën komtare të shqiptarve mbi token irredente shqiptare të cilat, me gjendjen e tashme të kufive, ngelin ndër sundimin serb dhe grek. Ktu fillojmë per së parit nga shqiptarët e mbetun në Jugosllavi. Tuej u permbajt besnik të njej programit realistik e shofim të pa dobishmne me shkue tepër thellë per me i kerkue në histori dokumentat e qenjes së tyne.

Nji shkrimtar dhe shetitës turk prej races slave i shekullit XVII, Miran Alem, thot per Shkupin: “Banuesit e ktij qyteti flasin shqip dhe jan muhamedan e katolik”. Në vjetin 1845, Jovan Bukaresky e verteton se Fusha e bardhë, Akova (Bielopolie) asht shqiptare dhe mbas tri vjete, në vjetin 1848, serbi Davidoviç rinjef se *Kosova dhe Metohija* krahina të Pejës, janë të banueme prej shqiptarësh². Në librin e vet të botuem në Paris në 1840 *La Turquie d'Evrope* Ami Boue, shetitës i njoftun dhe studjoz i forte, konstaton se shqiptarët janë të përzimun me srbt në fushën ose në rrafshinen ndermjet Prizrenit dhe të Pejës, në mes të Vranjes e të Mitrovicës, dhe zanë vetmas zonën e jugë –perëndimit të fushës së Prishtinës, viset në mes të Vranjes, Gilanit, Novibrodit, Prishtinës, Gjakovës, Kurshumlisë, Prekupës dhe të Medokës.

Nji shkenctar tjetër, Gjorgj Von Hahn, i konsideruem nder autoritetet ma të shqueta, në çashtjet etnografike të Shqipnisë, në librin *Albanesisches Studien* të tij (Jena 1854) thot se Shqipnija perhapet prej 39⁰ deri në 43⁰ latitudin në veri ose prej Prevezes në Jenipazar dhe përfshin mrenda tokëve të veta të gjitha buzët e detit me kater vilajetet, të Janinës, Shkodrës, Monastirit dhe të Shkupit. Prap në nji tjetër vepër të tij *Reise von Belgrad nach Salonik* (Vjen 1868) aj cakton vijen e kufinit në mes të shqiptarve dhe të sllavëve mbi lumin Morava.

Kto pohname gjejnë pelqimin e saktë në dhjet vjetat e më pastajm. Në 1869 sllavi Bradanska boton në *Mitteilungen* (mars 1913) nji studim ku rinjef qenjen e njej popullate shqiptare mjaft e konsiderueme pertej Shkupit deri në Vranjë dhe në Kumanovë, në Quprilië (Veles) dhe në Monastirë. Edhe prap. Në librin e shkruem në gjuhën bullgare mbi *Maqedhaninë* prej Vasil Kentchoff (Sofje 1900) dhe ndeper statistikat e njoftuna qi i shoqnojnë të gjitha *Hartat etnografike të ktyne vilajetve të Selanikut, Monastirit dhe të Kosovës*, të shtypina nga Instituti Hartografik i Sofisë, vërtetohet ktu shumica etnografike e shqiptarëvev ndeper shumë vende të viseve të vilajetit të Shkupit dhe të Monastirit.

Në *Shqipninë e panjohun*” (Albanie inconnue) të Jany (1913) asht shkruemun: Shqiptarët janë zotnuesat e pa kundërshtuesum të Gjakovës, të Prizrenit dhe të Pejës. Gjakova krejtsisht asht shqiptare. Peja e cila asht nji nga qytetet ma të shqueme të shqiptarve, asht qyteti ma i madh i shqiptarve të veriut. Per të gjatë vijës së hekurudhës prej Ferizoviqit deri në Mitrovicë, asht shum i madh numri i shqiptarve dhe shum i vogel numri i serbvet. Në fushen e Kosovës shqiptari ka nji perzotnim absolut..., Prishtina dhe Mitrovica janë të banueme prej shqiptarësh.

Asht tepër me tregue në të tilla tregime. Por nuk mund të lihen në harresë ato tregimet e paraqituna dhe të dorzue me në aktet diplomatike. Në raportin qi delegati Britanik në Komisjonin e Rumelijes orientale, Lord Fitzmaurice, i pat paraqitë Foreign Office'it, qi u botue në *Blue Block* në vjetin 1880 gjendet shkruem: *Vilajeti i Kosovës*, perveç

² I diftuem prej Iscirkov “Zopadnata Kraichta na bigarskata Zemja”, Viset e Prendimitmtë Bullgarisë”, Sofje 1915 Faqe LX.

njej pjese të vogël serbsh qi zgjatet prej kah lindja, tuej fillue nga Mitrovica, mund të konsiderohet plotsisht shqiptare. Gjakova, Peja dhe Prishtina, janë qendrat e aktivitetit të shqiptarve qi shtrihen prej kufinit të Malit të Zi deri në kufinin e Serbisë. Krejt vilajeti i vjetër i Prizrenit, qi perfshinte Dibren, Pejen, Gjakoven, Prishtinen, Shkupin dhe Tetoven e Gostivarin, ishte i dalluem prej vendeve slave, si nga lindja ashtu dhe nga juga.

Nji numer i shumtë shqiptarësh prap gjindet ndeper prefekturat e Jenipazarit, Tashligjës dhe të Senicës.

Në themel të ktyne pohimeve qi Lord Fitzmaurice i dokumentonte mbi ma t'auktoritetshmet Harta etnografike të konsiderueme, Ambasadori i jashtzakonshëm i Anglites pranë Sulltanit, Lord Goshen, insistonte prenë qeverisë turke që të krijohej nji provinçatë e madhe dhe e bashkume shqiptare, e cila të perfshinte vilajetet e Shkodres, të Kosovës, Monastirit e të Janinës, tuej njoftun në kte nji të drejtë të shqueme komtare të shqiptarve.

T'i marrim tash në shoshitje statistikat. Nuk asht aq e lehtë me i perbamun me saktësi. Edhe Turkija e cilla i qeverizoj ato vise shqiptare deri në vjetin 1913, nuk mujt me perpilue as nji here rregjistrimin e vertetë të ktyne vendeve shqiptare, sikurse duhesh me nji methodhë të forte e shkentifike, edhe as qi nuk u kujtesue per klasifikimin e banuesvet, sambas gjithve të ndryshme të foluna prej tyne, ose si mbas komsisë së tyne, por vetëm u kufizue me i dallue –formalisht dhe me nji mëndyrë empirike dhe aproksimative- sambas fenave të besueme e të mbajtuna. Per me tepër shqiptarët gjithmonë kanë diftue kundërshtim të madh per ka regjistrimi dhe klasifikimii tyne, tuj dyshue në qëllime të ndryshme ose mnije edhe ksisoji perherë kan me mshefë sa kan mundur njerëz gjith sa here qi kanë dashtun me i perpilue statistikat auktoritetet turke.

Në kohën e Inspektorit të Përgjithshëm, Hysejnë Hilmi Pashës, shuma e popullsisë së Vilajetit të Kosovës ishte njehsue mun në 1.063.666 banues, prej të cilvet 754.631 (shqiptarë) muhamedan.

Sikurse asht thanë ma pare turqit nuk merrshin parasysh komsinat, por vetëm fenat, dhe prandej në muhamedant e Vilajetit të Kosovës qi perbajnë ma se 75% të popullsisë duhet me i shenue vetëm për shqiptarë, me qenë se ndeper kto vise sikurse dihet mire, nuk jetojnë turqit. Por duhet m'e shenue se Vilajeti i Kosoves i cili perfshin administrativisht shumë krahina të cilat shqiptarët nuk i kërkojnë si vise komtare, për ket arsye zonen me të vërtetë shqiptare, d.m.th. pjesën e shqiptarvet mbi shumën e popullates tansore duhet me hype ma tepër se 75%.

Por t'a konsiderojmë në nji mëndyrë më të saktë ket rreshtim të numrave. Statistikat e fundit të Turkisë mrrijnë deri në pak muej per para luftës turko ballkanike. Kto statistika per vilajetin e Kosovës tregojnë nji shumë prej 1.134.499 frymë prej të cilve 829.756 shqiptarë-muhamedan (64,14%), 226-528 serbë (18,80 %) 204,021 bullgarë (15,76%), 20,349 shqiptarë-katolik (1.50%): dhe teprica e të tjera besimeve, janë protestantë, çifut dhe jevq.

Por ma të kjarta janë kto çifra per s'e cilin qark qi perbajnë Vilajetin e Kosovës. Në prefekturën e Jenipazarit mbi shumën tanësore të popullates prej 80.666 banuesvet: shqiptarë-muhamedan janë 52.833 (65.50%) dhe orthodox serb 27.814 (34.50 %); në prefekturën e Prishtinës mbi nji popullsi prej 364.855 (65.50%) shqiptarë-muhamedan 245.605 (70%) dhe orthodox serb 102.331 (28%). –Por duhet shenue

ktu se shum nder kta orthodox të shenuem si serb janë thjesht shqiptarë; në prefekturën e Pejës mbi një popullsi prej 185.779 banues, shqiptarë-muhamedan janë 133.901 (72-50 %) dhe orthodox-serbë janë 31.792 (15.20%); në prefekturën e Prizrenit mbi një popullsi prej 248.432, shqiptarë muhamedanë janë 195.047 (80 %) dhe orthodox serbë 31.491 (12.48%), dhe orthodox bullgarë prej Eksarkatit 16.599 (6.52%). Në qytetin e Shkupit, qi asht qendra e Vilajetit të Kosovës, mbi një popullsi prej 34.797 banuesvet, shqiptarë-muhamedan janë 22.013 (63.20 %) dhe orthodox grek 2.073 (6%), orthodox –bullgar 8.725 (25%).

Tuej vijue gjithnji sipas ktyne statistikave, të cillat sado qi nuk janë perfekte janë shumë të pa anëshme, pjesa e serbvet në popullsinë e vilajetit të Monastirit ku thellsija e popullsisë asht dhe kjo shqiptare, asht si vazhdon: krahina e Monastirit 484 mbi 123.372 banues; Prilepi 6.404 mbi 66.948 banues; Kërçova 10.51 mbi 39.772 banues; Ohri 1.556 mbi 59.795 banues; Dibra 615 mbi 61.015 banues.

Perveç ktyne gjendet edhe një tjetër seri statistikash: janë ato të plotsueme nga auktoritetet austriake në vjetin 1915-18, në kohën e pushtimit ushtarak të tyne në Shqipninë e sipërme. Ato u përkasin qendrave të cilat tash janë të zaptueme prej serbvet, të cilat shenojnë per Gusinë mbi 7.500 banuesa, 6.500 shqiptarë (36.7%); per Pejë mbi 75.119 banuesa, 62.419 shqiptarë (83.1%); per Gjakovë mbi 64. 456 banues, 62.595 shqiptarë (96.1%); per Prizren mbi 94.236 banues, 72.458 shqiptarë (76.9%); per Mitrovicë mbi 22.800 banuesa, 11.371 shqiptarë (49.4%); per Vuçiternë mbi 32.000 banuesa, 26.550 shqiptarë (83 %); per Prishtinë mbi 77.231 banuesa, 58.884 shqiptarë (76.2%); per Gilan mbi 54.594 banuesa, 31.100 shqiptarë (56.9%); per Tetovë mbi 84,600 banues, 37.620 shqiptarë (44.5%); per Preshevë mbi 43.352 banues, 15.153 shqiptarë (34.9%).

Nuk asht aq nevoja me vazhdue në kso shenime statistikash. Do të mjaftojë vetëm m’e përkujtue se tri Harta të mdhaja të botueme aty kah vjeti 1903 prej Institutit Hartografik të Sofisë, per m’e ndriçue kompozicionin etnik të popullsisë së vilajetevet Selanik, Monastirë dhe të Kosovës, edhe kto e rinjofin dhe e vertetojnë pergjithsisht shumicen e madhe numrore ndeper kto vise të sipërpermenduna. Mbas ktyne konstatimeve mund të kuptohet dhe mund të peshohet kjartazi artificaliteti i statistikave qeveritare të Jugosllavëvet në vjetin 1921, qi dishrojnë m’e paksue në një shumë vetëm prej 430 mijë shqiptarët mbi një popullsi tanësore prej 11.619.750 banuesash të Jugosllavisë. Nuk do të jetë e gabueshme prandej m’e pohue per qi shqiptarët në Jugosllavi janë ma tepër se një miljun. Dhe –si race thjeshtësisht autoktone –zanë dhe përmushin, me shumicën e popullsisë, viset e Liqenit të Shkodrës, krejt vilajetin e Kosovës dhe nenprefekturat e Ohrit, Dibres, Kerçoves, të Monastirit dhe të Florinës, qi bajshin pjesë me Vilajetin e Monastirit.

Mund të trajtohet skematikisht kuadra e viseve shqiptare qi sod janë nder sundimin e Jugosllavisë, mbi themelin e Hartes topografike të ngjitun në *Notice sur l’Albanie et Montenegro* e botueme nga Ministrija e Luftes Franceze në vjetin 1915.

Kto vise janë të caktueme në pjesën e tyne ma të domosdoshme. N’anen e liqenit të Shkodrës, tokët e përfshime midis Tivarit e grykëve të Bunës, ndeper buzët e detit Adriatik dhe anës perëndimore të liqenit: dhe ajo e përfshime në mes të Pllanicës (Maja e Jovan Begut), të Podgoricës dhe Brojës (ky katund asht brenda kufive të Shqipnisë së lirë) gjithnji n’anen prenimore të liqenit. Masandej viset e gjana e të mdhaja të kufinit të hershëm turk-malazez tuej pershimun mrenda Gusinë, Plaven,

Beranen –me ni hund qi futet deri n’Jakova (Fusha-Bardhë; serbisht Bielopolje)-, Rozhajen, Mitrovicën, Prishtinën, Kumanovën, Albanicën, Këqevonë e deri në pikën jugore ma të fundëshme të liqenit t’Ohrit. Në ket tokë të gjanë nuk gjindet tjetër pose shqiptarësh perveç ndo’i ishull i vogël serbësh ndë per qytete dhe pranë të ndonji lumit të madh dhe të ndo’i elementit bullgar n’anën e jugut në mes t’Albanicës dhe të Këqevës.

Po se aty nuk mund t’a pohojnë qenien e njëj shumice të madhe të njëj tjetër populli, qi mos të jetë serbo-orthodoks, serbt perpiqen dhe janë mundue me trillue disa tjera teorina të cilat u ndihmojnë per m’e mshefë, o s’pakut m’e paksue randësinë e popullit shqiptarë. Në ket mëndyrë ata qindrojnë e thonë, se muhamedantë e tokëve të reja qi ata i kan zaptue në vilajejtet e Kosovës dhe të Manastirit nuk janë shqiptarë, por turq.

Ktu duhet të spjegohem pak: fjalë turk në djalektin e Kosovës don të thotë muhamedan, e jo turk komsisht; prandej kur populli thot se jam turk-shqiptarë, do të thot vetëm shqiptarë muhamedan, pse aj turkun e *tyrk*. Pra, duhet mos m’e harrue qi në shekujt e parë të pushtimit të tyne të Gadishulles Ballkanike turqit e përhapen dhe e imponuen muslimanizmen me çdo far mjeti; e ma vonë ket fjalë fetare e shkëmbyen me fjalën e tyne komtare *turk* “(turq)” dhe në ket mëndyrë populli me diftue besimin qi ndjek qe mësue me thonë *turk* në vend qi me thane muhamedan.

Por ket pretezë serbe per m’e rrëxue, mjafton me i’u permendë atyne qi Bosnja dhe Hercegovina qi janë në pjesën ma të madhe muhamedan, porse Belgradi natyrisht nuk ka mendue dhe nuk mendon me i klasifikue si turq. Ndryshimi i faltores nder kto vise, i cili polli prej shum zaptimesh dhe propagandash fetare, nuk numrohet, as pak; dhe nuk ka randësi.

Të tri fenat, katolike, orthodokse dhe muhamedane, qi i kemi thane ma parë, zbashkut ekzistojnë në racen jugosllave. Kshtu qi natyrisht ndodhë se ndëpër qendrat e mdha, si në Prishtinë, Shkup dhe në Manastirë, shqiptarët të flasin edhe gjuhën turke, ose të flasin at gjuhë e cila per shum shekuj u qe zyrtare. Por edhe per ket arsye, ata qindruen dhe nuk e harruen gjuhën e vet shqiptare; një auktor studjoz bullgar i ktyne viseve, Jordan Ivanov, në vepren e tij *Blgaritev Makedonia* (Sofië, 1915) posaçërisht e rinjef qi populli muhamedan i Monastirit, i Ohrit, i Strugës dhe i Shkupit janë shqiptarë.

Shqiptarët është mjaft lehëtazi me i njoftë per tipin fizik të tyne të zakonshme dhe të posaçem, per doket ose zakonet e tyne, per krejt formen e jetës së tyne e cila nuk asht ajo turke, por trazhigimtare dhe karakteristikë mirë e njoftune shqiptare.

Serbt, kur nuk muejnë m’e permbajtë ket teori turke, orvaten me shpikë ndo ‘i tjetër: d.m.th. mundohen me i quejtë serb të muhamedanizuem. Edhe kshtu thonë se shqiptarët nuk janë tjetër vetëm serb të kthymë në muhamedanizëm në kohën e gjatë të pushtimit të turqve. Kjo teori e shpikun qe paraqitë bile edhe në dyert e Konferencës së Paqit prej njëj memorjali zyrtar të Jugosllavisë më 13 Prill 1919, në të cilën, per me kërkue një të drejtë serbe mbi Shkodër, pohnohesh se popullsia nga pikëpamja etnografike, simbas emnave të katundeve, mbas dokeve, bartja ose përdorimi i gunës, asht nga rraca slave dhe asht qenë e ç’kombtarizue prej turqvet. Asht Spiridon Gopelviçi i cili e ka perhapse një teori të tillë gjoja se serbët janë muslimanizue ose shqiptarizue porse perpara ktyne pohnimeve dhe pretezeve, n’a vjen me pyet: si mundet qi kta serb të fizionomisë shqiptare, të kenë zakonet e doket e

thjeshta shqiptare, të cilat i dallojnë krejtësisht sikurse nga pamja serbe ashtu nga ajo turke?

Ashtu edhe një tjetër fakt decisive që e johnon plotësisht këtë pseudotheori. Shqiptarët muhamedan të Kosovës, të Pejës, të Mitrovicës, të Gilanit të Prishtinës dhe të tjera qyteteve, rrjedhin prej *fiseve* të krasniqes, të Shalës, të Shoshit, të Thaçit të Berishës, të Mazrrekut, të Gashit, të Kelmendit, të Fandit dhe të tjera.

Fise janë rrjedhjet familjare ose barqe të cilat mbahen shenjtësisht dhe respektohen në Shqipëri dhe sipërme: janë institute tipike shqiptare, të cilat kurrë nuk janë gjetun dhe nuk kanë eksistuar në mes të serbëve dhe turqve; këto *fise* prandaj janë një karakteristikë e veçantë etnike sidomos në Shqipëri dhe veri-perëndim ku më mirë janë rrujtun, për më i dalluar shqiptarët prej turqvet dhe sllavëve. Por, për studimin t'atë këtu është më mirë më e këto doktrinën që mund të konsiderohet ndoshta edhe arbitrare. Vyen për në më tepër më i konsideruar popujt më siç janë dhe siç ata gjenden, si mëndojnë dhe si veprojnë sikurse komb ose shtet. Kështu dishron realizmi politik.

Perkundrazi, më mirë mund të flasim për që orthodoksit e viseve të Monastirit dhe të Kosovës, të cilat përfytyrohen si sllav, serb e grek, nuk janë tjetër përveç se shqiptarë thjesht autentik. Të tillë kemi në Elbasan, në Durës, në Berat, në krejt Shqipëri jugore deri në Prevezë dhe në Jeninë. Këta njëjten për kah gjuha e thjesht shqiptare, të cilën e flasin dhe vazhdojnë si përherë më folë e përdorur ndër familjet e tyre. Për këta mund të thohet se më të vërtetë janë shqiptarë sipërfaqsisht të sllavizuar, të cilat më gjith natyrën e tyre komtare, dendin e rritin statistikat e regjistrimeve dhe shifrat sllave.

Ky kjarësim fillestarë vijnë më shpague edhe terminologjinë e krijuarë prej serbësh për më këto vise se gjoja kanë një vjetërsi dhe një të drejtë serbe të cilat kurrë nuk kanë ndodhun. Në këto terminologji: është *Serbija e Vjetër* në të cilën Hartat e tashme serbe duan më futun një pjesë të Shqipërisë së sipërme dhe sidomos Vilajetin e Kosovës e të Monastirit. Ky emër *Stara Serbija* (Serbija e vjetër) është qenë krijuar në vjetin 1827 tuej u dukun për herën e parë në *Harten e Principatit të Serbisë* botuar më Belgrad prej Jovan Bugarsky'it.

Në Harten gjeografike të Vuk Kogjiçit e botuar më Belgrad në vitin 1827, Serbija e vjetër akoma nuk eksistonte. Nuk është e para herë –dhe këto dihet –që shtetet të cilat lakmojnë pushtime tokash krijojnë emra të ri fetarë që mund t'u lehtësojnë ose t'u ndihmojnë dishka t'afërshme më ta dhe kështu të formojnë një rrjedhje opinioni në favor të kërkesave t'ardhshme të tyre.

Këtu, perkundrazi, në del rasti më biseduar për një proces t'ashpërt të sllavizimit të shqiptarëve, që banojnë ndër viset e zaptuarë prej serbvet dhe që krijojnë një mëni të pashirueshme midis të dy komeve dhe për më tepër e kërcen ende një herë paqin e ballkanve; pse kundër këtyre sllavizimit të mënshëm ngrihet i bashkuar dhe i njëjtë krejt populli shqiptarë si aj mënda Jugosllavisë ashtu edhe aj për jashta kufive të sajë. Serbt e dijnë më mirë se më gjendjen e sodëshme e të tyre, më një shumicë të pabesueshme të popullsisë shqiptare e cila dishron indipendencën e vet dhe që i mbrojnë të drejtat e veta komtare, pushtimin e vilajeteve të Kosovës dhe të Monastirit edhe ashtu të viseve shqiptare të veriut të marrun tash sa vjet prej Malit të Zi, nuk do të mundin kurrë se si më i konsoliduar.

Për këto arsye prandaj është që ata përpiqen më mish e më shpirtë për më i'a u ndryshuar fizionominë, për theksin dhe thjeshtësia shqiptare e atyre viseve të robuarë nuk

zhduket dot, dhe prandej ata i perdorojnë kundër shqiptarve metodat ma brutale e barbare të sllavizimit, pergjegjsinat e të cilvet sod i'a mshefë dhe i'a u siguron vetëm kontrolli i rrallë dhe i largët Evropjan.

Ky sllavizim bahet prej burimesh të ndryshme dhe me forma të ndryshme. Shqiptarvet i'u janë johnue fare shkollat shqipe: jo vetëm ato botnore, qeveritare ose bashkijore, porse dhe ato private të mbajtuna me të hollat e shqiptarve. Auktoriteti jugosllav e justifikon ket sundim johnues të shkollave shqipe tuej thonë se nuk eksiston nji gjuhë shqipe. Ksodore nder qeverimin Jugosllav, komi shqiptar ka ma pak të drejta se ato qi i pat pasë ndër qeverimin turk.

Per m'e ruejtë shqiptarizmen në familjet e tyne dhe per m'e ruejtë t'ardhmen e gjuhës së vet shqiptare, i dergojnë fëminë e vet perjashta kufive, ndeper shkollat e Mretnisë shqiptare. Me qenë se gjuha shqiptare nuk asht e njoftune natyrisht asht e ndalueme rrebitsisht qi të perdoret ndër aktet zyrtare. Nuk asht e lejueshme as nji dishirë shqiptare, bile as në rase të ndo'i bamirsije. As nji deputet nuk mundet ma m'e perfaqsome në Skupshtinë(parlament) komin shqiptarë. Deputeti i vjetër Nazmi Gafurri asht qenë i vramun në vjetin 1927 në Prishtinë pse vuri kandidaturen në zgjedhjet e fundit politike. Nji tjetër kandidat shqiptarë, Ferhat Draga, po per kto arsye asht qenë i denuem me njizet vjet burgim të randë. Edhe shqiptari Jusuf Ahmeti asht qenë vramun vetëm pse qe zgjedhun Këshilltarë i Bashkisë së Prishtinës. Shumë prej kryetarve të bashkinave ndeper viset e ndryshme të Kosovës prej vjetit 1921 deri në vjetin 1925 janë zhdukun e mbytun në ket mëndyrë prej auktoriteteve serbe. Në ket gjendje shqiptarët nuk duhet të jetojnë ose t'apin shenj gjallnijet.

Lëvizja e serbizimit vazhdon me anë të kishës s'orthodosvet serbe e cila perpiqet me çdo mëndyrë per me i terhjekë katolikt, muhamedant dhe orthodoxt shqiptarë, por se kta i kundërshtojnë rrebitsisht dhe nuk afrohen n'at racë anmike prej shekujsh.

Por të mprojtunit e qindrimi i shqiptarve per kunder luftimeve sistematike per zaptimin e pasunive të pa tundshme të tyne, mbas luftës evropjane, u ba shum i vështirëshem, pse serbt me fuqinë brutale të tyne i ndjekin dhe i hjekin shqiptarët e bullgarët prej vatrave dhe prej tokëve të tyne tuej instalizue në vendin e ktyne katundarët serb e malazez. Ky largim ose espropriacion bahet, siç tham, me mëndyra barbare dhe t'egra, pa u dhanë as ndo'i shperblim. E në ket mëndyrë katundarët serb dhe malazez grabisin truëllin dhe pasuninat e shqiptarve gratis.

Ktu kuptohet kjartazi se në ket mëndyrë Serbia qillon me i serbizue edhe malazeztë, tuej i'u falë vendet shqiptare malsorve të Malit të Zi të viseve të veri-lindjes, dhe vendin e malazezvet e mbushë me katundarë –bulq të Serbisë. Me ket system janë krijue disa zona mjaft të gjana ku dhet vjet ma parë nuk gjendesh as nji serb: per shembull, ndeper krahina të Pejës dhe të Gjakovës. Shqiptarët tuej pamun gjendjen e tyne aq kritike dhe luftimet mizore, të Serbisë, shtrengohen me u emigrue disa n'Amerikë dhe disa në Shqipninë e lire, tuej krijue nji çeshtje të vështirë refugjate.

Në qoftë se kjo mëndyrë barbare serbe per me i largue shqiptarët nga vendet e tyne dhe per me çrranjosë nga komsija do të vazhdojë akoma, per pak gjeneracione humbjet e tokëve komtare të shqiptarvet do të mërrijnë në nji shkallë të panumrueshme.

Por atëherë kur kjo politikë e egër e sllavizimit nuk mjafton per me i'a mërrij ktij qellimit, Serbia perdoron nji metod ma të shpejtë dhe ma të sigurtë: shtypjen e egër, vrasje dhe masakrime. Mund t'a pohnojmë pa gabim –sikurse faktet e verifikojnë –se

masakrimet me shumicë, të marruna parasysht gjakftoftsisht, bahen e zhvillohen në themel të prirjeve dhe të mjeteve të veçanta të politikës së tashme serbe për me paksue dhe m'ë simplifikue çështjen komtare që asht absolutisht kundër të drejtave e interesave të serbëve: ket barbarizëm e perdorë ndër ato vende ku nuk asht krejt syni dhe kontrolli evropjan. Ky metod mizuer asht fillue në kohën e luftës turko-ballkanike dhe shpejt mbas sajë; e cila akoma vazhdon pa premun fare.

Në perfundimet e komisionit hetues të naltpërmenun për ballkan, dhe simbas shenimeve *Carnegie*(1913-14) lexohet: “Djegëjet e shpijave dhe të katundeve, egërsimet e pa ndigjueshme, plaçkitjet e grabitjet dhe barbarizmet janë mëndyrat dhe mjetet të cilat janë të gjdo lloji. –Ja kto janë mëndyrat dhe mjetet të cilat trupat ushtarake serbo-malazeze i kan perdorue me qillim për m'ë transformue e ndryshue fizionominë etnike të vendeve të banueme dhe të popullueme thjeshtisht prej shqiptarësh”. Kto i vëretetojnë vet serbt, dhe po në një gazetë të tyne të Beligradit, *Radnichke Novine* me 9/22 Tetuer 1913 asht botue një letër në të cilën ndër të tjera asht thane: “Luma nuk eksiston ma. –Nuk ka mbet tjetër veç se kufoma, pluhun e hi. –Janë katunde prej 150 ose 200 shpijash ku nuk gjendet ma as një njeri. –Na i mbledhim shqiptarët gropa-gropa nga 40-50 vetash dhe i therrshim e i pershkojshim ndërper bajonetet t'ona deri sa i mbythim krejt”.

Kjo mëndyrë barbare ka vazhdue edhe mbas luftës Evropjane.

Komiteti i Mprojtjes Komtare të Kosovës ka dhanë lajme të sigurta dhe me lista të plota me emnat e viktimeve të Shqiptarve, të masakrimeve të bamuna prej serbvet, aty kah janari e shkurti i vjetit 1919 në Vilajetin e Kosovës.

Në prefekturën e Prizrenit janë njehsue 836 vetija të vramuna, dhe 770 shpië të djeguna e të prishuna; në prefekturën e Pejës 1563 vetija të vramuna dhe 714 shpija të djeguna e të prishuna; në prefekturën e Mitrovicës 133 vetija të vrame dhe 42 shpija të djeguna; n'ate të Prishtinës 4600 vetija të vrame dhe 2190 shpija të djeguna; në Vuçiternë 2179 vetija të vrame dhe 1463 shpija të djeguna; në Ferizoviq 1694 vetija të vrame dhe 452 shpija të djeguna; në Preshevë 267 vetija të vrame dhe 180 shpija të djeguna: në ket mëndyrë shuma e pergjithashme e shqiptarve të masakruëm nga ushtritë serbo-malazeze mërrijnë në 12.371 dhe e shpive të djeguna ose të prishuna mërrijnë në shumen 650. Asht e domosdoshme m'ë rrëfye se në mes të ktyne dishmorve shifen ma tepër burrat, kryetarët e familjevet, dhe ata që dukeshin se ma shum do t'ishin të zotët dhe në gjendje të shëndoshë për riprodhimin e racës së tyne shqiptare dhe për permbajtjen e mbrojtjen e familjes së vet.

Kto masakrime vazhduan edhe në vjetët e ma pastajshme: bile ma të shpeshta e ma të randa se t'ermeneve që u organizuen prej turqve, për të cilat shum herë ndërhyri Evropa. Në vjetin 1920 tridhet katunde shqiptarë në krahinën e Dibrës janë djegun dhe prishun prej ushtrisë serbe. Protestimet e shqiptarvet nuk janë marrë parasyshtë. Thirrjet e ankimet menjherë janë vue në heshtje.

Perfaqsesat e irridentistvet shqiptarë për çdo vjet janë ankue tuej u drejtue ndërper kancelaritë e mdha t'Evropës dhe sidomos në *Lidhjen e Komeve* për masakrimet e therorizmat Jugosllave kunder shqiptarvet. Bile edhe në ket kohën e fundit janë drejtue memorjale nga irridentet e komeve, tuej protestue masakrimet dhe ekspropriacionin e shqiptarve të Kosovës nga vatrata e tyne prej serbvet. Kto thirrjet e fundit dhe memorjale, u permenden vrasjet brutale të tashme të meshtarit komtarë At

Shtjefnit Gjeçovi dhe të ish deputetit Nazim Gafurri. U kerkue më shpejt një hetim i paanshem që të bahet në vend për sa ndodhë atje.

Por hetimi i kerkuem nuk u ba. Thirrja dhe fjala e Shqipnisë nuk u ndigjue. Porse për ma tepër asht edhe një rrezik i madh ajo që Serbia mund t'a bajnë një kercnim, pushtimi në viset e Shqipnisë indipendente. Në Belgrad akoma vazhdon ideja imperialiste për m'e zaptue token shqiptare deri në detin Adriatik.

Mas tentativit Jugosllav, ma nalt të permendun, që e shtyti kryengritjen e Mirditës në vjetin 1921, e bani edhe atë të fundit në Nanduer 1927, me anë t'emisarve të vet dhe të refugjatvet të ardhun nga tokët Jugosllave për me i ndezë në një kryengritje të rrezikëshme viset e Dukagjinit. Edhe një kryengritje e frymzueme dhe të ushqyeme prej qellimeve dhe mjeteve të hueja, u shtyp dhe qellimi Jugosllav falimentoj.

Prandej, prej ktyne kercnimeve të persrituna, Shqipnisë iu dasht me sigurie, dhe kshtu bani paktin e pare t'aleancës me Italinë i cili u perfundue në Nanduer 1927, e që konfirmue e zhvillue prej paktit të miqsisë dhe të sigurimit të nënshkruem përpara një vjeti. Pa as ndo'i arsye në Konferencën e Paqit në mbledhjen me 14 Janarë 1919, Pashiçi, dhe Trumbiçi, insistoishin me kërkesat e tyre për retifikimin e kufive për kah ana e kufive të lindjes; kerkonte edhe që Shqipnija të neutralizohej dhe të ç'ushtrizohej fare. Ky mendim nuk ish tjetër veç se m'e lane Shqipninë një shesh të dobët për me mundun m'e pushtue lehtazi: pa ndo'i perkrahje ose mprojtje të mrendëshme dhe të perjashtme.

PUSHTIMI GREK

Kuadri i viseve shqiptare, vuemun ndër thundren e zaptimit grek, asht po aj që e kemi trajtue për Jugosllavinë. Zaptuesit e sunduesit e huej të Shqipnisë irredente, sikurse në veri ashtu edhe në jugë, puqen po në një palë metode politike të njejta të shprehjes së tyre dhe po në një palë të njejta doktrinash arbitrare.

E para karakteristikë e zaptimit grek asht për me johnue qenjen e nejt shumë të madhe të popullsisë shqiptare mrenda kufive të vet, dhe kjo shifet kjartaz ndeper statistikat e perpilueme nga grekt. Regjistrimi i qeverisë greke i bamun me 1 janar 1921 ep jo ma shum se 5.065 nenshtetas shqiptarë për të gjith tokën ose viset e Grekisë. Por vetëm në Grekinë e vjetër gjenden s'paku 130 mij shqiptarë t'ardhun prej emigrimesh të bamuna për të gjatë të shekujve dhe sidomos në kohën e zaptimeve të turkut.

Gjinden me mijëra shqiptarë të njoftun vetëm n'Athinë, masandej mjaft gjenden n'Atikë dhe në Selanik. Por mbi kta shqiptarë që banojnë atje qysh prej kaq kohe tuej ruejtë zakonet e thjeshta dhe gjuhën e vet, me gjith se të perzimun me një shumicë greke, Shqipnija natyrisht nuk dishron me kërkuë ndo'i të drejtë.

Shqipnija irredente nder sundimin helenik, asht ajo që u lëshue ndër sundimin grek si mbas traktatit të Berlinit, me Paqen e 1913-tës mbas luftës turko-ballkanike, dhe me rretifikimet e reja të kufive të bamuna prej Konferencës s'Ambasadorve për mbas luftës Evropjane.

Ndeper kto vise, si mbas shenimeve statistike të turqve që janë ba me një mëndyrë fare të paanshme, popullsia ndahet –si mbas komsisë dhe besimit –në ktë mëndyrë që vijon: Distrikti i Kosturit –popullsia e pergjithshme 96.325 banues, d.m.th. 37.118

shqiptarë, 30.983 bullgar, 14.987 vllah, 13.238 grek; në Krahinën e Filatit –popullsia tansore 28473, d.m.th. 22.348 shqiptarë, 6125 grek; në Krahinën e Gumenicës – popullsia tansore 10126, d.m.th. 10.126 krejt shqiptarë dhe as një grek; në krahinën e Ajdonatit -popullsia tansore 16.355, d.m.th. 13.780 shqiptarë, 2.575 grek; në Krahinën e Margjilitës –popullsia tansore 15. 723, d.m.th 15. 723 krejt shqiptarë dhe as një grek, në Krahinën e Pragës –popullsia tansore 1.300, d.m.th. 800 shqiptarë, 500 grek. Shuma tansore prandej ndërper viset e Shqipnisë jugore që i'u janë lëshue Grekisë, mbi një popullsi të përgjithshme prej 168.303 banuesve, shqiptarët ishin 99.895 (afër 600 për qind) dhe grekt vetëm 22.438. Për sikurse u pa, në disa krahina shuma tansore asht absolute shqiptare pa qenë as një grek.

Në të verteten viset irredente shqiptare, tash të pushtume prej grekve, përhapen në pjesen ma të shumten nga ana e brigjeve të Adriatikut, prej kufimit të tashëm të Shqipnisë deri në atë të Komarës me një thellësi kah perëndra e ndryshueshme në mes të 30 e 50 kilometra (viset e Çamrisë) dhe për të gjatë të krejt kufinit veriu që ndryshon në mes të 10 dhe të 30 kilometrave.

Por grekt kanë dashtun m'e krijuar një konfuzion në ket pasqyrë ose kuadër që të kjo të numrave, dhe janë mundue me i shenue dhe me i konsiderue si grek të gjith banuesit e ktyne viseve të cilt –si mbas statistikave turke –figurojnë si orthodox. Nder aktet e shtetit-civil, dhe prandej ndër shenimet të Parantorisë Otomane të krishtenët orthodox janë qenë qujtun *rum* d.m.th. grek. Por kjo asht spjegue se autoritetet turke në rregjistrimet e tyre nuk merrshin parasysh komsinë, ose gjuhen e perdorue, por vetëm fenë e besueme ose të mbajture.

Tash, tuj e lanë me një anë faktin që në Shqipninë jugore ekzistojnë shumë muhamedan –për të cilt grekt heshtin –duhet m'e kjoarsue se të marrunit pjesë në kishën greko-orthodokse nuk asht as pak e mundun me i'u cilsue shqiptarvet komsinë greke.

Shqiptarët orthodox mbetën gjithmonë shqiptarë: nuk janë dhe nuk dishrojnë me u ba grek. Kte e provon fakti ma parimtar i lëvizjeve të tyre komtare të bamuna dhe të kryeme, siç mirë dihet, për lirinë e kputjen nga kisha greke e Konstantinopojës; kjo lëvizje u përngjanë të gjitha atyne lëvizjeve komtare krishtene që mvareshin ndër influencen e Patrikut ikumenik grek, ndër sundimin Otoman, dhe masandej u këputen prej tij po sa u liruen nga turkija: ndër kto lëvizje që kisha e Rumenisë, Serbisë, Bullgarisë dhe ajo e Dodekanezit.

Mund t'admetohet se, midis të kësaj popullsije shqiptare të ktyne viseve, do të ketë fitue ndo'i influencë prirja greke, siç janë qen influencimet e turqvet dhe të grekvet ndërper viset e tjera shqiptare: kur kjo influencë e tillë asht një fakt natyruer që ndoshi në zonat kufizore komtare e cila nuk mundet as pak e kurr m'e ndryshue thellsinë ose thelbin komtar e origjinal të popullsisë.

Nuk duhet m'e harrue at që, ndër sundimin turk, atherë kur ishin të qiluna shkollat greke, ato të shqiptarvet ishin rrebitsisht të ndalueme. Në ket pikë, zoti Venizelosi, dhe natyrisht, donte me kte m'e ndryshue te verteten e fakteve, edhe kshtu që u paraqit në Konferencen e Paqit, me pretendimin e tij të panumrueshme mbi viset shqiptare, për m'e dishmue gjoja, një të drejtë komtare greke, tuj thonë se në Epirë, në kohën e Turkisë, ekzistoshin shkollat greke dhe nga shkollat shqiptare ishin vetëm një në Korçë.

Z. Venezelosi harroj m'e spjegue ate per qi krejt shkolla shqype e Korçes ishte fare shkollë private e jashtzakonshme e cila ishte e vueme nder mbrojtjen e flamurit Amerikan. Por menjherë pas revolucjonit të Djelmënisë turke (zhon turqvet) shofim se fillon me lulzue në Shqipnië një lirië e re komtare; fillojnë me u hapë me qindra shkolla shqiptare në gjuhën amtare shqipe ndër orthodoxit shqiptarë. Dhe orthodoxit shqiptarë të Korçës, të ciltë, zbashkut me shqiptarët muhamedan kishin luftue per kunder Turkisë në vjetin 1908, po sa hynë ndër mprojen e trupave franceze në Nanduer të vjetit 1916, i hapen shkollat shqiptare dhe nuk deshten ma me njoftë tjetër gjuhë dhe tjetër shkollë; Kshtu me ket mëndyrë ban dhe orthodoxit e Gjinokastres posa u liruen nga robnia e ushrive greke.

Tuej i persritun argumentet qi u shprehen dhe qi u lëkundën në Sërbi të cilat i konsideruem ma nalt shofim se edhe në Greki, per m'e paksue randsinë numrore të popllit kompakt shqiptarë, lozet një rrol djallzuer per m'e mohnue se gjoja muslimant e atyne viseve nuk janë shqiptarë por se turq. Ktu nuk n'a mbetet tjetër gja vetëm se me i hedh poshtë, kto preteze greke, po me ato arsyenat e nalt të diftueme me të cilat rrëxohen vet-vetiu pretezat e gabushme serbe.

Muhamedant e Shqipnisë jugore sikurse ata e të tjera viseve fenë e kan marr prej turqvet siç e mueren muslimant e Bosnje-Hercekovines (nder të cilt ndoshta shumë janë racë sllave) por nuk e mueren gjuhen turke të cilen nuk e perdorin dhe as nuk e kuptojnë fare, muk mueren tipin fizik e as doket e zakonet dhe as shpirtin e prirjet turke. Ata janë ruejt deri më sod shqiptarë të pa përlyem, tuj u bashkuem me shumicë të madhe me vllaznit e tyne orthodox per ne luften e perhershme qi paten kunder turqvet, per lirinë e independences komtare.

Sikurse në Serbi që u shpik një formul e *Serbisë së vjetër* per me pretendue eksistencen e njej të drejtes së vjetër serbe, por se e pa themel, per viset orientale të Shqipnisë, ashtu në Greki flitet per *Epirin e Epër* per një pretendim mbi viset jugore të Shqipnisë së lirë dhe per pjesen qi akoma ajo e ka nder pushtimin e vet. Kjo nuk asht tjetër vetëm një terminologji e propagandes politike, e cila nuk qindron para kritikes historike e në themele të konstatimeve komtare. Hartat gjeografike dhe etnografike të Lejean'it në vjetin 1861, dhe të Kiepert'it në 1876, të Karl Sax-it në 1878, e provojnë të gjitha kjartazi se viset e quejtuna *Epire* nuk janë tjetër veç se pjesë jugore të Shqipnisë.

Por se edhe per kto vise të shqiptarëve, të kërkueme dhe të zaptueme prej grekve, duhet mos t'i harrojmë se grekt me një system t'eger politik të tyne perpiqen pa premun me i grekizuem. Gjuha shqiptare nder qeverimin grek nuk asht e njoftun: shkollat shqipe nuk janë të lejueshme. Me tjetren anë, sikurse asht pamun, nenshtetasit shqiptarë në Greki gjithnji grekizohen ndeper statistikat, dhe proprieteti prodhuës ose çdo pasunië u asht e ndalueshme.

Traktati i Paqit i kan dhan të drejtë Grekisë per me i largue, nga viset e pushtueme rishtaz nga grekt, popullsisë muhamedane tuej i'a u konfiskue pasuninë e tyne. Grekija e zbaton ket të drejtë edhe per mbi shqiptarët.

Në vjetin 1936, qeverija greke, në një notë të drejtueme në Lidhjen e Komevet, kishte premtuem per m'e ndalue shfardo mas e qi mund të jenë kundër shqiptarvet. – “populli i Çamrisë (viset shqiptare të pushtueme) do të përgëzojnë po këtë traktament qi gzojnë të tjerët nënshtetas helenik, ky traktament do t'u permbahet në ligj dhe në

fakt, thoshte nota në fjalë. –Çdo masë e jashtëzakonshme qi qeverija e kishte perdorue kunder këtij populli do t’ a anulonte”.

Por mbas tri vjetve kto premtime të Grekisë mbeten fare në harresë.

Janë pezullue ekspulkimet shqiptare: por tokët e shqiptarëve të grabituna nuk i’u kthyen ma ktyne. Pasunitë shqiptare u janë dhanë nga qeverija greke refugjatve grek t’ardhun nga Asia e Vogël dhe kshtu populli shqiptarë nuk ka ma as të drejta dhe as mjete të gjallnimit, e per ket shkak asht qi shqiptarët shtrengohen me u emigruer perjashta ose me u humbë ndëper zonat ma t’errëta të proletariatit.

Besoj se mjaft mirë i kemi përkujtue masakrimet e shkretnimet e fshatrave shqiptare të kryeme prej grekve në Shqipninë jugore, por me ato sisteme e qellime të serbvet kundër Kosovës. Edhe ktu, aty ku nuk mund të i’ a harrijnë politikës per ç’komsimin e shqiptarvet, perdorin masat ma brutale per zhdukjen e shqiptarve.

Por se kto perdhuni dhe masa t’ashperta e t’egra, tash per tash janë ma të lehta se ato qi serbija vazhdon akoma t’i zbatojnë kundër shqiptarvet qi i mban ndër sundimin e vet.

NJISIMI EKONOMIK

Në ket myndyrë që e diftuem, sikurse në veri e në lindje, ashtu edhe në jugë, kundër serbvet dhe grekvet qindron edhe gjindet një problemë e Shqipnisë irridente, e cila akoma nuk ka marrë një caktim dhe prandaj pret zberthimin e zgjedhjen e sajë.

Kjo çështje merr një karakter të posaçëm e me randsi, pse ne ket çështje permblihet jo vetëm nevoja e qellimi i një bashkveprimit ose solidaritetit shpirtnuer midis shqiptarve mrenda dhe pertej kufijve të Shqipnisë, por ma tepër per një nevojë të ngutshme per mbrojtjen e komit shqiptarë kundrejt rrezikut real dhe të dikshem të humbjes ose të zhdukjes së viseve komtare ma me randsi, të kërcnuem prej njëj politikës brutale të ç’komtarizimit, e cila perdoron çdo mjet dhe per deri vrasjen me shumicë. Kjo masë e egër tregon efektin e vet të sigurtë dhe të mnershëm, në të rralluemit dhe në të zhdukunit e shpejtë të popullit shqiptarë ndër viset e pushtueme.

Duhet prap të shtojmë dhe t’ a sjellim ndër mend se cungullimi i tashëm i Shqipnisë nuk paraqet vetëm një pa drejtësi qi nuk durohet dhe coptimin e njëj enti komtarë, qi nuk ka ndonji shembëll të tillë ndër popujt e Evropës, por formon një krim tuej lëshue ndër sundimin e huej pjesen komtare të Shqipnisë e cila asht shumë ma e madhe se mretnija e tashme indipendente.

Cungullimi politik i Shqipnisë, në ket mëndyrë, e ka shkëputë e cungullue edhe njësimin ekonomik të saj dhe me kte e ka ngushtue tepër gjendjen e vështirë të jetës së sajë.

Kjo çështje e njësimin ekonomik të Shqipnisë qi ka të bëjnë drejt per drejt me ate të njësimin komtar dhe toksuer, nuk asht qenë kurrë e konsiderueme me një vrejte të mjaftueshme dhe prandaj edhe kjo duhet me qenë mirë e caktueme , ashtu n’ate etnografike, Shqipnija e ka pasë dhe e ka akoma sod në Ballkan një fizionomi të veten fare mirë të dallueme e të shqueme.

Nuk duem të flasim per kohnat e kalueme dhe të lashta. Vëtëm dishrojmë të sjellim ndër mend se në një kohën e romakvet, Shqipnija ishte ajo qi lidhtye Romen, ose okçidentin me orientin e Evropës dhe t’Asisë. Udha ma e madhja qi e pershkonte

Adriatikun dhe Ballkanin, ishte rruga *Egnatia*, e ndertueme prej romakvet, e cila tuej fillue nga Durësi, bjen ndeper Elbasan dhe Ohri, dhe kshtu mrite ne Detin Egjeo dhe në Selanik, dhe prej ktu deri në Kostantinopojë. Kto qarkullime tregtare u persëriten edhe në Mes-kohë.

Në shekullin XIV, shqiptarët, mbasi i dbuen dhe i shporren sllavt, tuej i ndjekun buzët e lumejve, ngjallen dhe lulzuen një jetë ekonomike në fushen pjellore dhe pasanike të Kosovës dhe të lumit Vardarë, dhe ksodore kanë muejtun m'e sundue qarkullimin e konomik të Ballkanit qendruer me gjith Selanik. N'at kohë shqiptarët ishin zotnuesat e tregtisë si per mrenda, ashtu n'Adriatik dhe në detin Egjeo. Gadoi në të gjitha qytetet e mrendëshme të Shqipnisë edhe po n'ato qi sod quhen Maqedhani, gjindeshin magazina të tregtarvet shqiptarë të cilt qarkullojshin per tregti n'Adriatik me anë të skeleve të Shkodrës dhe të Paguzhës dhe me detin Egjeo me anë të Selanikut. Kjo e provon se jeta ekonomike e Shqipnisë perbante një njisim të vetëm kah qendra e Ballkanit (në viset Kosovë-Manastirë) dhe pershinte kshtu krejt Ballkanin; e në ket njisim asht qi e kishte arsyen e të qenunit të vet, me qenë se kjo puqet plotsisht me njisimin komtarë.

Tuej i lanë më një anë kto perkujtime të kalueme, ma gjith qi janë të ndriqeshme, po marrim parasysh gjendjen e tashme të Shqipnisë ekonomike. Themeli natyrorë i ekonomisë ashtu sikurse i komsisë asht në gjeografi. Njisimi i komeve asht plotsuem simbas nevojave të veçanta të jetës ekonomike dhe të mprojtjes komtare të cilat gjejnë caktimin e tyne ndëpër vijat natyrore gjeografike.

Shqipnija sikurse paraqitet nga të përhapunit e tashëm etnografik, perbahet prej shum malesh të shterrpta dhe të theposuna edhe prej katër fushave: a)Fusha e Kosovës; b)Fusha e Metohisë; c)Fusha e Zadrimës; ç)Fusha e Myzeqesë.

Kosova dhe Metohija janë të vetmet fusha me të vërtetë pjellore dhe të begatshme, të zonjat me dhanë një prodhim të shpejtë. Ma e shumta pjesë e Zadrimës, dhe katër të pestat e Myzeqesë –një vend afër 900-kilometrash katrore –janë kneta e moqala, malerike e të pa prodhueshme. Të dy zonat pjellore –të Fushës së Kosovës dhe të Metohisë, prodhojnë grunë, misër, elb, tërshanë, pemë të ndryshme dhe të tjera. Misri qi prodhon Fusha e Metohisë asht ma i shumtë se sa ka nevojë vendi: në ket mendyrë teprica eksportohet perjashta. Gruni i Kosoves dergohet deri ndër mullitë e Selanikut e të Shkodrës. Me gjith kte, të dy Fushat –Kosovë e Metohi –janë të vetmet tokë me të vërtetë prodhuese të Shqipnisë; në gjendjen e sodëshme i janë këputun kombit të shqiptarëvet edhe i janë lëshue njej sundimit skllavnuer: Jugosllavisë.

Janë këputë prej Shqipnisë edhe Peja e Gjakova qi prodhojnë një shumë të madhe duhani, e po kto të dy qytete i janë dhënë Jugosllavisë; edhe me tjetren anë viset e Pargës dhe të Prevezes, i janë lëshue Grekisë, të cilat prodhojnë shumë voj e qi eksportohet në Malta dhe n'Australi.

Ekonomia bujqësore e Shqipnisë, me gjith-se në vet-vedi ep një prodhim të lehtë, me kto këputje e cungullime, asht shkretnue dhe shemtue në burimet ma me randsi prodhuese.

Por se edhe krejt sistema tregtare e Shqipnisë, e formueme per të gjatë shekujsh si mbas qarkullimit natyrër të tregtinave, në mardhënie të posaçme në mes qyteteve dhe të fushave, midis anëve të detit dhe viseve të mrendëshme, asht qenë tash ma krejt e thyeme dhe shtrenguemun me pushue. Mjafton me marr parasysh një herë harten e kufive të ri të Shqipnisë per me i konstatue gjendjet e gabueshme dhe të rrezikshme qi

kan dashtun me i'a krijue qarkullimit të saj tregtarë. Në veri Shkodra mbetet e vetmueme dhe e preme prej të gjitha rrethinave të veta (në lindje dhe në perëndim të liqenit) të cilat në pjesën ma të madhe i'a ushqejshin jetën e sajë dhe qarkullimin tregtarë e gjallnuer të saj. Sidomos kjo ndodhë ma me randësi në kto vende t'ona, ku akoma nuk asht krijue një ekonomi industriale, e ku gjindet dhe asht një mardhanje dhe një endje tregtare e shtrenjtë dhe e domosdoshme në mes të qyteteve e të fushave per rreth.

Në veri-lindje persritet po aj fakt cungulluës.

Viset popullore dhe të frytshme shum me randësi të Gjakovës, Pejës dhe të Prizrenit të cilat gjithmonë e paten zberthimin e tyne natyruer në Shkodër dhe qi në ket qytet perherë lulzoi tregtija dhe pazari i tyne, ende kto tash janë këputun dhe mbetun perjashta. Shkodra kshtu humb krejtsisht tregtinë e vet, dhe të tjera vise shqiptare qi e ushqejshin, ngelin perjashta e të vetmueme. Por ma teper per te gjatë të kufinit oriental të Shqipnisë, viset shqiptare i kishin e i kan pajimet ushqimore të gjallnimit në vendet e Pejës, të Gjakovës, të Prizrenit, t'Ohrit dhe të Dibrës, të cilat qytete kanë kalue ndër sundimin Jugosllav. Në fund të jugut, viset e Konispolit, qi perballojnë Kanalin e Korfuzit dhe qi i kan nevojat e tyne të shpejta, rrahjet dhe endjet e tyne gjallnore me detin, janë damun prej tij dhe perjashtue nga kufini i ri grek.

Gjith kjo, nuk rrudhë dhe nuk shterngon vetëm mundshmëninë ekonomike të Shqipnisë, por e ven krejt ekonominë shqiptare ndër kontrollin e drejt per drejtsheem të Grekisë dhe per ma tepër e ma rrezikisht, vetëm tuej i mbyllun kufijt, me i mbytë unit gadi krejt vendet shqiptare.

Nga kjo ndërsymje dhe nga ky kercnim i randë Shqipnija nuk mund të lirohet, e vetëm në njenen pjesë do t'ishte e mundun, dhe kjo vetëm me anë të gaditjeve dhe ndertimeve të portave(skeleve) të reja dhe të rrugëve të reja të mrendëshme, të cilat sod janë tuej u plotsue e tuj u realizue me shpejtë me të bashk-punuemit e italljanvet.

Turkija e kishte kuptue në kohen e fundit nëvojen e domosdoshme të njesimit ekonomik të Shqipnisë dhe e ka pasë fillue organizimin e njej sistemi të komunikacionit në mes të prefekturës së Shkodrës dhe të Kosovës, midis fushave dhe detit, -tuej ndertue –me sakrifica të mdha të finances shqiptare –rrugat Shkodër – Podgoricë, Shkodër –Kuks, Prizren Kuks, Prizren –Ferizoviq, Prizren-Gjakovë, Gjakovë-Pejë, Pejë -Mitrovicë, Prizren-Tetovë, dhe kshtu Urat mbi lumin e Drinit (Ura e Drinit dhe ajo e Vezirit në Fan).

Ksisoji Shqipnija puqet, në njasinë e natyrshme të veten, me Shqipninë etnike, të cilat po të dyjat qenë të këputuna per me i sherbye interesave strategjike dhe gulshimeve ekonomike, natyrisht jo komtare, të viseve e të racave të hueja.

Në krejt caktimin e sistemit të shtjellueshem të kufive të popujvet ballkanik n'as një pikpamje nuk u mueren parasush interesat e Shqipnisë. Në ket mëndyrë natyrisht asht krijue një Shqipni irredente, ma e madhe dhe ma e gjanë se ajo indipendente, dhe kjo Shqipni irredente, prej qi nuk mundet me vdek prej s'gjallit dhe me u ba kriminalja e e vetvedit, randon nevojat kah pjesa e vet komtare qi asht në liri, pse vetëm në kte e gjenë shprehjen, ruejtjen dhe dishiren e shpresen e jetës dhe të nderit.

E DREJTA KOMTARE

Asht koha qi tasht ma mos t'a zgjasim ket studim t'onë kshtu të ngutshëm mbi problemin komtare të Shqipnisë. Komisjoni hetues, i emnuem prej Shoqnisë së Komeve në Tetorë të vjetit 1921, mbas kryengritjes së Mirditës qi qe shtytun prej qeverisë së Belgradit, dhe i cili perbahet prej Kolonelit Schaffer të Luksemburgut, prej Majorit Meinich të Norvegjisë dhe prej profesorit Thesleff të Finlandës, në përfundimet e veta konstatoj (e vërtetoj) se komi shqiptarë asht, mund të thohet, e vetmja racë qi mund të shqohet e të caktohet auktoktone në krejt Gadishullen Gallkanike: ky Komisjon e phonon me ballë të hapët se prej zhvillimit të ndjenjës komtare shqiptare mund të shpresohet shumë; per origjinalitetin e racës shqiptare, per doket e zakonet e tjera dhe per flakrimin e gjallë të mendjes së tyne, mund të priten dhe të shpresohen ndihma të shqueme per në përparimin e Ballkanit. E phonon prap se Shqipnija e lire dhe indipendente asht një konditë fare e domosdoshme per paqin dhe kjartësinë në Ballkan.

Kto konsiderata krejt të anëshme dhe të ndershme të hetuesve të heuj neutral, qi i rivertetojnë –sikurse do t'a shofim ma vonë –edhe të tjerat perfundime ndërkomtare të tillëshme të shprehuna me një here ose ngjitë mbas traktatit të Berlinit, në 1880, atëhere kur lëvizja komtare e shqiptarve fillon me u shque në bashk-qenjen aktuale, të cilat mjaftojne per me inkoadrue thjeshtisht perballë të tanë Evropes çeshtjen Shqiptare. Traktohet prandej per një kom i cili e ka fare të drejtë me qenë i rinjoftun dhe me jetue siç jetojnë të gjitha të tjerat kome ballkanike, qi nuk mund të shkëmbetet dhe të përzihet me të tjera raca; dhe se shteteve të këtyne racave të hueja nuk mund t'u shtrohet kurr, edhe se nuk mundet me qenë i shtypun dhe i cungulluem per pa provokimin e natyrshem të një reaktionit të fuqishem qi mund t'a shkaktojnë mbar organizmat e gjalla, të forta dhe të shëndosha të tij.

Komi shqiptar asht i gjallë dhe i flakët. Të katër karakteristikat e tij, qi ngrehen prej kuadrit ma nalt të trajtue, janë ato qi i'u banë ballë të gjitha atyre ngjarjeve të perkunderta, omogjeniteti i njisis së viseve të veta gjuhsore, të solidaritetit të vet shpirtnuër dhe të pohnimit trimnisht e shqiptarisht të së drejtave të veta.

Mjafton m'e perkujtue vetëm një çast historinë e sajë dy herë mijavjeçare, mjafton m'e mendue pushtimin e romakve, të serbvet, dhe të grekvet, qi vazhdoj tuej e perseritë një pas një prej tune deri në kto vjetët e fundit, per me muejtë me kuptue mirë se sa i randë e i mburshem asht thelbi ose thellsia komtare e ksajë race qi e ka ruejtë të pa perlyëshem nga prishjet dhe demoralizimet e të huajvet tipin e vet fizik, gjuhen e vet amtare, doket e zakonet e veta, formen e organizates së vet shoqnore si edhe ndjenjen e vet t'indipendencës.

Kjo ruejtje e mrekullueshme mjafton per m'e dokumentue po ne ket kohë ende qindresen etnike të racës dhe ndryshimin e dallimin absolut nga të gjitha racat e tjera qi e rrethojnë, qi e kanë pershkue dhe do të dishiroshin m'e sundue. Por, ma shumë se çdo tjetër vend etnografik i gadishulles ballkanike, ky i Shqipnisë së lire dhe i asaj akoma irredente, formon një tansi të njëjtë, omogjene, per pa ndo'i zberthim të vazhdimit dhe të ndërhyrjes ose të penetrimit t'elementeve të huej.

Hartat etnografike të studjozve të huej të pa anshem, qi e sherbejnë të vërteten e jo propaganden e politikave t'interesueme, e provojnë kulluetshmeninë e jashtzakonshme mrenda viseve gjuhsore dhe etnike shqiptare e cila fillon me i'u psuemun shkëmbimeve të dhimbëshme dhe t'egërta të politikës serbo-grke per

ç'komzim të racës shqiptare dhe kolonizimit të tyne. Kjo njisië race dhe gjuhe asht edhe njisi ndjenjash.

E kemi thanë ma nalt se qyshë prej agimit të themelimit e të fillimit të lëvizjeve të reja politike t'irridentizmes shqiptare, qyshë nga ditët e traktatit të Berlinit, muhamedant dhe krishtentë, të veriut e të jugës, kan bashkpunue vllaznisht per m'e pohnuë të drejten e tyne komtare të njinjishme. E kemi spjegue edhe se dallimet fetare në mes të muhamedanve, katolikve dhe orthodoxve nuk duen të thonë as pak dallesë shpirtnore e t'interesave dhe aq ma pak dallim komtarë.

Po ksisoji dallimesh eksistojnë në Jugosllavi dhe në Greki, ku per ma shum ndeper ishulla dhe sidomos në Kretë, gjinden akoma sod shum grek muhamedan. Ky dallim feje asht qenë me të vertetë, në shekullin nandëmdhetë, qendra e puqjes së kundërshtimit politik e të tri Perantorinave Evropjane qi konkurrojshin per kontrollimin e Ballkanit.

Perantoriya e Ruisë së Carve mpronte orthodoxizmen sllave dhe dishronte me i vue nder kte të gjitha racat dhe fenat e tjera kombeve ballkanike; Perantoriya Austro-Ungarike perpiqesh me hy me anë të katoliçizmes; Perantoriya Otomane mpronte në vendet e pushtueme parimin muhamedan.

Mbi pjesët e fesë të kombit shqiptarë pasqyrojshin dhe perfytyrojshin kto politika të ndryshme të tri Perantorinave. Mbi katolik shqiptarë kacavaresh Austro-Ungariya, e cila tuej qenë e forte në të drejtat protetorate ndaj katolikve romak të njoftun nga traktati i Pasaroviçit e i Karloviçit, pergatiste edhe ndeper ket rrugë perhapjen e influences së vet ndëper Ballkan; *Draganç Osten* i tij mbi orthodoxsit e ushtronte vepren e vet të politikës pansllave të Ruisë, e cila e shifte në kta vetëm një element per m'e ia bashkue fuqive komtare slave dhe per me i mbajtë kto perkundër Turkisë qi ishte rritun aq fort; dhe ma në fund Turkija pështetesh mbi muhamedant me anë të cilvet dishronte me i'u ba ballë ktyne dy fuqive të forta kundërshtare, dhe barazisht me i'u ba ballë lëvizjeve të rrezikshme të ktyne dy perantorinave rivale.

Ky nkryqzim politikash muejte me krijue dukejn e një dallimi në mes të pjesve të ndryshme të fesë shqiptare dhe secila prej tyre pa dashtun as pak ishte e thërritune per me i shërbye njej politikës tjetër të huej.

Por tash kto të tri Perantoriya u shkatruen me luften Evropjane dhe në ket mëndyrë nkryqzimet e tyne në Ballkan mueren fund. Shqipniya kshtu kthehet të jetojë në prirjet e saja natyrore qi janë ato –mrenda dhe jashta kufive –të njej njisimit kombtarë politik në mvehte dhe në sherbim t'interesave shqiptare edhe të paqit ballkanik.

Per ket të drejten e njisimit politik qi e realizon indipendencen e krejt komit, shqiptarët e kan luftuem ndër çdo formë dhe me çdo mjet. Dhe kjo perpjekje e luftë e tyne asht një dokument i ngjithshem i ndërgjegjes dhe i vullnetit të pa tundshëm të tyne komtarë.

I kemi diftue fazat ma me randsi të ksajë. Kjo ka episode (ngjarje) vjetiake dhe të mdha në levizjet e Skenderbeut (të Gjergj Kastriotit), por zhvillimi ma i madh dhe ma tipik asht ba në shekullin nandëmdhetë, siç asht ba ndeper të gjitha të tjerat kome ballkanike, dhe kjo sidomos mbas vendimeve të traktatit të Berlinit, qi per te paren e heres e vuen një problemë politike reale të kufive per ballë të kombit shqiptarë.

Kundër politikës së padrejtë të Fuqinave të Mdha populli shqiptarë, me gjith se keq i armatuem, por të bashkuem nga shtytka ose prizja komtare, liftoj dhe qindroj krezhnikisht per rresht katër vjet; kshtu qi vetëm në vjetin 1882 Mali i Zi dhe Serbia

muejten me i shtije me të vërtetë ndër sundimin e vet viset Shqiptare të shenueme nga Konkresi si mbas vullndetit të Rusisë.

Me ket qindresë burrnore, me të cilen nisë me të vërtetë lëvizja kontemporane e kombit t'onë, Shqiptarët definitivisht i kan caktue e kristalizue dishirat e tyne komtare e politike per themelimin e njej Shqipnije indipendente në të cilën të mlidhen dhe të bashkohen, me krejt qytetet, të katër vilajetët shqiptare: Shkupi, Shkodra, Monastiri dhe Janina.

Kerkesat e *Lidhjes së Prizrenit* janë po ato qi perseriten në vjetin 1913, per mbas luftnavet ballkanike, e edhe në 1919 e 1920 per mbas luftës Evropjane per kunder po Italisë qi kishte pushtue Vlonen; dhe kto levizje të kerkesave komtare vazhdojnë akoma sod pa as një ndryshim.

Qyshë se kan fillue kto lëvizje kërkesash të drejtave komtare, janë ba tash ma pesëdhjet vjet jetë, edhe kto tash përesin perfundimin dhe zberthimin e tyne. Me kto do të themelohet ose do të *perbahet Shqionija e vertetë e shqiptarve*, e domosdoshme, e fortë, e shëndoshë dhe e gjallë, me të vërtetë e aftë edh'e zonja per lirinë; *do të bahet me tre miljun banues* prej të cilvet nuk mund të jenë ma shum se një e dheta nga elementet jo shqiptarë, d.m.th. serb, grek, bullgar, vllah e jevq: kjo shifet e duket mjaft mirë e rrudhëshme në qoftë se mëndohet ajo qi në kohën e themelimit të shtetit bullgar indipendent, Bullgaria përmyllte në gjinin e viseve të veta një popullsi të përbame gadi per gjysëm prej turqvet.

Per m'e justifikue robnimin e të gjith atyne shqiptarve ndër sundime të hueja, asht perfolun per një qytetnim ma të naltë të Jugosllavëve dhe të grekve. Kjo pikpamje, në Konferencen e Paqit, qe një argument i z. Venizelosit.

Por në qoftë se me të vertetë asht bisetue dhe se asht ba Çeshtje puna e qytetnimit, atëherë si ndodhi e qysh muji qi në Dallmatije Italjant i futen ndër sundimin e Jugosllavisë? Shka asht ky qytetnim ma i naltë i Jugosllavëve dhe i grekvet?

Atëherë kur Serbia u lirue prej zgjedhës së Turkisë në vjetin 1878, natyrisht nuk ishte ajo qi ka mundun me u perbamun sod në pesdhet vjet liri jete dhe nisjative komtare. Kte e provon gjendja, natyrisht jo ma e naltë se e atyne të viseve shqiptare ma të vorfënat dhe ma të largëtat të popullsisë serbe të pushtueme mbas vjetit 1913.

Por se aftsjia e njej qytetnimit ma të nalët të shqiptarvet asht provuem prej perparimit dhe prej zhvillimit të shpejtë të tashëm qi i ka rrëfye në çdo fushë të Shqipnisë indipendente. Pretendimi i njej qytetnimit ma të naltë të jugosllavëve dhe grekvet do të jetë në realitet vetëm nga kisha krishtene –rivaliste e faltores muhamedane –dhe qi kjo akoma sundon shumicen e popullit shqiptarë. Por ktu kjo çeshtje merr në ket rasë një pamje tjetër, e cila duhet ma mirë të kthjellohet prej Fuqive të Mdha t'Evropës të cilat kan njoftun indipendencen dhe të dretat e shum vendeve të ndryshme muhamedane.

Me gjith kte muhamedanët e Shqipnisë nuk janë nga Asia, siç janë turqit: po janë autokton t'Evropës. Kta i apin –ndër popujt ballkanik –perkrahje e ndihma borgesisë intelektuale dhe çeshtjeve e punëve të tjera jo ma pak se të tjerat besime.

Si pajtohet pra pretendimi i njej qytetnimit ma të naltë jugosllav dhe grek me prishjet e shkretnimet e tyne të paraurdhnueme, me masakrimet programatike të tyne, me politikën e egër të pasosune të tyne, pa as ndo'i pike shkëndije të liberalitetit, qi ata kan mujtun me bamun dhe qi vazhdojnë dita me ditë akoma sod kundër popullit shqiptarë, edhe, po, ndër nënshtetas të tyne?

E vërteta është se Shqipëria deri më këto vjetër e fundit nuk ka pasë mjetun me i gëzuar mirsinat e një lirie komtare dhe me mjet m'e ba që t'i ndigjohet zani i sajë ndër qarqe të duhuna dhe aty ku duhet. Ajo ka kaluar si në njënen është dhe në tjetrin sundim të huej: viset e saja janë qenë vum në shërbimin e plotë t'interesave politike të Fuqive të Mdhaja.

Në vjetin 1913 si dhe në 1919, kurë bisetohesh për caktimin e kufive të sajë, viset e veta i ishin pushtuem prej ushtrive serbe, malazeze e greke me sistemet shtypse e perdhunuese sikurse i kemi dituem ma parë.

Shqipëria kurrë nuk ka pasë përkrahës. Të gjithë të tjerët popuj ballkanik, grekët, serbët dhe bullgaret, sikurse kemi rrëfyer, lirinë tonë komtare dhe formimin shtetnuër e zmadhimin e tyre, e kanë fituar me anë të përkrahjes të Fuqive të Mdhaja t'Evropës.

Në këto mënyrë Shqipëria nuk pat ndonjë përkrahje të tillë.

Përkrahja nga Italia vetëm në këto kohëna e fundit fillon me ofruar ose me dhanë përfundime të mira.

Sa do që Shqipëria vjen ma vonë –në mes të komeve të tjera ballkanike –në zhvillimin e historisë politike të sajë, kjo nuk kishte me formuar ndonjë arsye për me hëkë dorë nga përparimet e saja, të cilat janë jo vetëm ekonomike dhe kulturore, por për mbi të gjitha komtare. Shqipëria, edhe kjo e ka të drejtë e meritë at lirinë e independencen komtare të cilën Shtetet e Mdhaja t'Evropës e pohojnë ndër programet politike ndërkomtare të tyre.

Kjo independencë tansore e Shqipërisë, e cila kërkon ma tepër se me dyfishuar gjendjen toksore të veten, nuk ka për qëllim të plotsojë vetëm idenë komtare të popullit shqiptarë, por edhe me i shërbye çështjes së paqit të Ballkanit dhe t'Evropës. Sidomos nuk është e mundur të përbahej një stabilizim i vertetë i paqit në Ballkan, deri sa mos t'u ipet e drejta e duhur popujve të ndryshëm që dita me ditë ankohen e shfaqen për lirinë dhe për lirinë e tyre nga ashpersinat dhe masakrimet që i psojnë nga sundimi i huej: si përfundim i këtyre egërsinave dhe i këtyre të pa drejtave komtare, ndër të tjerat, janë për t'u shenue ato që i'u janë ba shqiptarve të mjerë, këto janë ma të randat dhe t'ashpërtat.

Nuk mundet me pasë paq në Ballkan për pa i ba riparacionet e nevojshme. E për ma tepër një Shqipëri e përnamune në kufitë e drejtë të vet, me një frymë jo vetëm Adriatike por edhe ballkanike, e cila mvarret në zgjanimin e viseve komtare të veta, do të mundet m'e krye një veper të çmueshme t'ekulibrit midis kombeve të tjera ballkanike, jo të gjitha paqifike, për shërbimin e paqit t'Evropës.

Ky fakt që parapa qyshë prej vjetit 1880, prej diplomacies së Britanisë Madhe. Në një letër të veten Lord Grosvenor –Ambasador i Britanisë Madhe pranë Sulltanit –që me 26 korrik 1880, i'a dergonte Lord Granville'it i thonte kështu: “Për t'ishte themeluar një Shqipëri e forte, do t'ishin zhdukë arsyenat e ndonjë pushtimit nga ana e ndonjë fuqisë Madhe të huej, në rrasë të ndonjë shkatërrimit të Perandorisë Otomane. Një Shqipëri e tillë e forte, do të mbyllte rrugat në veri dhe do të mbante Gadishullen Ballkanike ndër durr dhe ndër sundimin e autoriteteve që e pushtojnë. –Një popullsi në pjesën ma të shumtën muhamedane kishte me qenë një burim i madh pengues për popujt sllav dhe grek që duhen t'i zaptojnë këto vise. –Kujtoj se mundshmëria e ndërhymsjes evropjane në Gadishullen Ballkanike paksohet në përpjestim të krijimit të komsisë shqiptare”.

Në të vërtetën Lord Groshe shifte në formimin e një Shqipërie të fortë dhe të madhe mrenda kufive të saj komtarë, ma të sigurten perkrasje të formules, qi sot shpesh herë perseritet: *Ballkani per popujt e Ballkanit*.

Por se aj e kuptonte edhe rrezikun qi paqit ballkanik i vinte nga një pushtim sllav e grek ndërper viset shqiptare.

Kto të vërteta akoma sod mbeten të pa ndryshueme.

N'asht se kan ramun influencat sllave e austriake në Ballkan, nuk mund të johnohet ajo qi mos të zhvillohen të tjera influenza sod nga ana e fuqive Evropjane.

Jugosllavija qi u themelue në vendin e Austrisë, me programin e sajë të shqetsueshëm dhe të rrezikshem per perhapjen e sajë në Ballkan, paraqet vet-vetiut kerknimin kundrejt të cilit krejt sistemi politik i Ballkanit asht ftuemun me i ba ballë per paqin e Evropës.

Shqiptarët nuk kanë qellime imperialistike, dhe gjith at thjeshtësinë trazhgimore luftarake të tyne, kerkojnë –në Ballkan –tokë ose të drejta qi mos qenë shqiptare. Nuk kerkojnë kurr tjetër vetëm te drejten e tokëve të veta. *S'e i cili pjesën e vet.*

(Fund)